

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5946
E enjte, 5 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €

Meta dekoron shpëtimtarët
e Kosovës për ndihmën
dhënë pas tërmetit FAQE 4-5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

JEMI TË TRONDITUR F. 5

Rexhep
QOSJA



REFLEKTIM PËR PISA F. 8

Prof. Asoc. Dr.
Arben
DËRMAKU



TËRMETI, SHTETI DHE NJERËZIT F. 11

Nga Bedri
ISLAMI



AKTUALE

KDI-JA: KA ARDHUR KOHA PËR LIGJIN PËR LOBIM NË KOSOVË F. 7

WEBER: EVROPA NUK MUND TA INJOROJË RËNDËSINË STRATEGJIKE TË BALLKANIT PERËNDIMOR F. 2

PUNËTORËT SHËNDETËSORË PRESIN QË NË FUND TË MUAJIT T'I MARRIN PAGAT ME RITJE F. 7

EKONOMI

ASK-JA: PAGA MESATARE BRUTO SILLET RRETH 378 EURO F. 9

KULTURË

'NI ZO I LIRË!' F. 12

Agim VINCA

DHEMBJE PËR ITAKËN F. 12

Sabile KEÇMEZI-BASHA

HËPËRHË KANË NGE CUR BISEDIMET NË MES TË LËVIZJES
VETËVENDOSJE (LV) DHE LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK)
PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE FAQE 3

POSTI I PRESIDENTIT BLLOKON ARRITJEN E MARRËVESHJES LV-LDK



Marrëveshja për koalicionin e ardhshëm qeverisës ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka hasur në bllokadë pasi që LDK-ja po dëshiron ta përfshijë në

këtë marrëveshje edhe postin e presidentit të Kosovës, i cili, sipas mandatit kushtetues, duhet të zgjedhet në pranverën e vitit 2021. Për këtë gjë nuk po pajtohet Lëvizja Vetëvendosje e cila po e konsideron të

padiskutueshëm postin e presidentit. Ndërkaq njohësit e proceseve politike në vend kanë thënë se LV-ja dhe LDK-ja duhet t'i ulin tensionet dhe të veprojnë me përgjegjshmëri ndaj popullit për krijimin e qeverisë

FLET PËR "EPOKËN E RE", RRAHMAN JASHARAJ FAQE 4-5

Askush s'duhet të ndihet i liruar nga përgjegjësia për rezultatin në PISA



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Presidenti Thaçi udhëtoi për në Berlin

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëtuar për në Berlin të Gjermanisë, ku do të marrë pjesë në konferencën e organizuar nga Instituti "Lindje-Perëndim". Në këtë konferencë pritet të marrin pjesë përfaqësues

të lartë shtetërore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Presidenti Thaçi do të jetë në një panel me ish-ambasadorin gjerman Wolfgang Ischinger, ish-ambasadorin amerikan Frank

Wisner si dhe ish-përfaqësuesen për Politikë të Jashtme të BE-së, baroneshën Catherine Ashton.

Në këtë panel do të flitet për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe për perspektivën evropiane të shteteve të Ballkanit Perëndimor.



NATO: Veprimet agresive të Ruisë paraqesin kërcënim

Udhëheqësit e vendeve anëtare të NATO-s thanë të mërkurën në Londër se veprimet agresive të Ruisë ishin një kërcënim për sigurinë euro-atlantike dhe se ndikimi në rritje i Kinës ka paraqitur sfidë për aleancën

LONDËR, 4 DHJETOR - Liderët e Aleancës Veriatlantike u mbledhën të mërkurën në një vendpushim golfi pranë Londrës për të paraqitur një front të bashkuar në mes të mosmarrëveshjeve të hidhura mbi terrorizmin, Turqinë dhe rritjen e ndarjes së barrës me Shtetet e Bashkuara.

Udhëheqësit e vendeve anëtare të NATO-s thanë të mërkurën se "veprimet agresive" të Ruisë ishin një kërcënim për sigurinë euroatlantike dhe se ndikimi në rritje i Kinës ka paraqitur sfidë për aleancën.

Në një deklaratë të lëshuar pas një samiti të mbajtur në periferi të Londrës, 29 udhëheqësit riafirmuan lidhjet e qendrueshme transatlantike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut dhe marrëveshjen e mbrojtjes së ndërsjellë midis tyre, përmes së cilës një sulm kundër një vendi anëtar vlerësohet si një sulm kundër të gjithëve.

Ata, gjithashtu, ftuan sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, që ta fillojë pro-

cesin e reflektimit mbi të ardhmen e aleancës, ka njoftuar rfe.

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, anuloi një konferencë të planifikuar për shtyp pas samitit. "Kur t'i mbarojnë takimet e ditës së sotme unë do të shkoj përsëri në Uashington. Ne nuk do të bëjmë një konferencë për shtyp në afërsi të NATO-s sepse kemi bërë kaq shumë gjatë dy ditëve të fundit. Udhëtime të sigurta për të gjithë!", ka shkruar në "Twitter" presidenti amerikan.

Samiti u mbajt në 70-vjetorin e themelimit të aleancës ushtarake e cila u krijua nga Shtetet e Bashkuara, Kanadaja dhe 10 vende evropiane më 1949 mbi parimin e mbrojtjes kolektive, mes shqetësimeve për zgjerimin sovjetik.

Në hapje të takimit mikpritësi i samitit, kryeministri britanik, Boris Johnson, tha se vendet aleate nuk duhet të tremben asnjëherë nga diskutimi për realitetet e reja dhe kërcënimet emergjente. "Historia tregon se



paqja nuk mund të mbetet si diçka e garantuar", tha Johnson. Ai deklaroi më pas se udhëheqësit e NATO-s e kanë mundësinë ta forcojnë unitetin dhe qëllimet e aleancës.

Me gjithë deklaratimet për unitet dhe mbrojtje të përbashkët, takimi dyditor kaloi nën hijen e një tensioni midis vendeve aleate. Dita e parë e samitit dyditor përfshinte një pritje nga Mbretëresha Elizabeth II në Pallatin Buckingham, një vizitë, rezidencën zyrtare të kryeministrit britanik dhe takime të ndara midis krerëve të NATO-s.

Fillimi i samitit u karakterizua nga mosmarrëveshjet midis aleatëve për çështje përfshirë

operacionin ushtarak të Turqisë në Siri, si dhe komentet e muajit të kaluar nga presidenti francez, Emmanuel Macron, i cili kishte deklaruar se NATO-s i ka "vdekur nga truri" dhe se angazhimi i ShBA-së për bllokun po venitet. Disa orë pasi arriti në Londër, presidenti amerikan Donald Trump tha se përshkrimi i Macronit për NATO-n është "shumë fyes" dhe se ai ishte treguar "shumë mosrespektues" në ato komente.

Sidoqoftë, presidenti amerikan u tregua më i butë ndaj liderit francez gjatë takimit të tyre të përbashkët më vonë gjatë ditës, duke thënë se Uashingtoni dhe Parisi ndajnë së bashku "përp-

jekje shumë të mira", ndërsa theksoi se ekzistojnë disa mosmarrëveshje të vogla mbi tregtinë.

Derisa po përgatitej mbajtja e samitit, dy çështje kyçe janë ngritur nga vendet anëtare: shpenzimet e mbrojtjes dhe marrëdhëniet midis Turqisë dhe vendeve të tjera anëtare si Franca.

Para nisjes për në kryeqytetin britanik, presidenti turk Recep Tayyip Erdogan, tha se ai do të kundërshtonte planin e NATO-s për mbrojtjen e vendeve baltike nëse aleanca nuk e mbështet Turqinë në luftën e saj kundër grupeve kurde në Siri që ajo i konsideron terroriste.

Weber: Evropa nuk mund ta injorojë rëndësinë strategjike të Ballkanit Perëndimor

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, i shoqëruar nga nënkryetarët Agim Veliu dhe Vjosa Osmani dhe anëtarët e Kryesisë, Besian Mustafa dhe Vlora Dumoshi, kanë pritur të mërkurën në takim kryetarin e Grupit të EPP-së në Parlamentin Evropian, Manfred Weber, shoqëruar nga përfaqësuesja e posaçme e BE-së dhe shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, Andrey Kovatchev, deputet në Parlamentin Evropian, Nina Tavcar, këshilltare për politi-



ka e Weberit dhe Riccardo Serri, zëvendës shef i Zyrës së BE-së në

Kosovë. "Jam shumë i lumtur që kam vizituar Kosovën sot. Unë

jam këtu për t'i zhvilluar marrëdhëniet tona të mira dhe për ta nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit tonë në EPP. EPP-ja mbetet e përkushtuar ndaj procesit të zgjerimit dhe partneritetit tonë afatgjatë për qeverisje të mirë, zhvillim ekonomik dhe stabilitet. Evropa nuk mund ta injorojë rëndësinë strategjike dhe historike të Ballkanit Perëndimor për kontinentin tonë", ka thënë Weberi.

Ndërkaq kryetari Mustafa e ka uruar Weberin për rezultatet e Kongresit të EPP-së muajin e kalu-

ar dhe e ka falënderuar për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme që i kanë dhënë EPP-ja dhe CDU-ja LDK-së dhe Gjermania Kosovës. "Në emër të LDK-së dhe qytetarëve të Kosovës ju falënderoj ju z. Weber, partinë tuaj, CDU-në dhe familjen tonë politike, EPP-në, për përkrahjen që i keni dhënë Kosovës në proceset euro-integruese dhe presim përkrahjen tuaj të mëtutjeshme në këto procese, veçanërisht për liberalizimin e vizave sa më parë për qytetarët e Kosovës", u shpreh Mustafa.

Hëpërhë kanë ngecur bisedimet në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për formimin e institucioneve

Posti i presidentit bllokton arritjen e marrëveshjes LV-LDK



Marrëveshja për koalicionin e ardhshëm qeverisës ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka hasur në bllokadë pasi që LDK-ja po dëshiron ta përfshijë në këtë marrëveshje edhe postin e presidentit të Kosovës, i cili, sipas mandatit kushtetues, duhet të zgjedhet në pranverën e vitit 2021. Për këtë gjë nuk po pajtohet Lëvizja Vetëvendosje e cila po e konsideron të padiskutueshëm postin e presidentit. Ndërkaq njohësit e proceseve politike në vend kanë thënë se LV-ja dhe LDK-ja duhet t'i ulin tensionet dhe të veprojnë me përgjegjshmëri ndaj popullit për krijimin e qeverisë

për media ka theksuar se është e përkushtuar ta respektojë dhe zbatojë vullnetin e qytetarëve të Kosovës të shprehur në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. "Në këtë drejtim, ne kemi shprehur vazhdimisht gatishmërinë dhe zotimin tonë të palëkundur për arritjen e një marrëveshjeje bashkëqeverisëse me LV-në, bazuar në fuqinë politike që ua kanë dhënë votuesit dy partive, në frymën e bashkëpunimit drejt mbrojtjes dhe avancimit të interesave shtetërore të Kosovës. Lidhja Demokratike e Kosovës ka punuar dhe është e vullnetshme të arrijë një marrëveshjeje të baraspeshuar, të qëndrueshme dhe afatgjatë", është thënë në komunikatën e LDK-së.

Më tej në këtë komunikatë theksohet se diskutimet mes dy partive, LDK-së dhe LV-së, do të vazhdojnë në mirëbesim dhe mirëkuptim, pa iu nënshtruar presioneve publike të askujt dhe duke krijuar një ambient të përshatshëm dhe racional. "Synimi ynë i përbashkët është të arrijmë një marrëveshjeje që ka prioritet vetëm dhe vetëm zotimet tona ndaj qytetarëve të Kosovës për ta përmirësuar mirëqenien e tyre", është thënë në këtë komunikatë të LDK-së.

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, në takim me kryetarin e Grupit të EPP-së në Parlamentin Evropian, Manfred Weber, ka theksuar se kanë arritur t'i bashkërendojnë të gjitha parimet e programit bashkëqeverisëse me LV-në sepse, sipas tij, tanimë kanë hyrë në fazën përfundimtare të përmblyljes së marrëveshjes politike. Në takimin e fundit lideri i LV-së, Albin Kurti, pati thënë se ka përafrime, por ende ka dallime. "Nuk jemi marrë vesh, mirëpo ka avancim në diskutimet që i kemi bërë. Atëherë kur do ta kemi marrëveshjen e plotë mund ta shpalojmë atë gjerë e gjatë. Këtu

përfundon takimi i sotëm e unë jam në kontakt të drejtpërdrejtë me kryetarin e LDK-së që ta përcaktojme takimin e radhës", ka deklaruar Kurti.

LV-ja dhe LDK-ja janë pajtuar që qeveria e ardhshme t'i ketë 12 ministri me nga dy zëvendësministra për secilën ministri. Bazuar në numrin e votave të fituara më 6 tetor, Lëvizja Vetëvendosje do t'i ketë 29 deputetë në Kuvendin e Kosovës, LDK-ja 28, PDK-ja 24, koalicioni AAK-PSD 13 dhe Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë 6 deputetë. Ndërsa nga komunitetet joshumicë, Lista Serbe 10 deputetë, si dhe 10 vende kanë fituar së bashku të gjitha partitë e minoriteteve joserbe.

Thirrje për formimin e shpejtë të institucioneve të reja kanë bërë ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ai i Britanisë Nicholas Abbott, ambasadori gjerman Christian Heldt dhe shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova.

Analistët: LV-ja dhe LDK-ja duhet t'i ulin tensionet

Njohësi i proceseve politike në vend, Lulzim Peci, ka thënë se LV-ja dhe LDK-ja duhet t'i ulin tensionet dhe të veprojnë me përgjegjshmëri ndaj popullit për krijimin e Qeverisë së Kosovës. "Para së gjithash, ato duhet të 'aterojnë' dhe të jenë të vetëdijshme për fuqinë vetjake politike, me ç'rast duhet edhe të kenë parasysh se tani PAN-i i dezintegruar ka më shumë deputetë (43) sesa në legjislaturën e kaluar (39). Fitorja relative nuk mund të barazohet me fitoren e zgjedhjeve, pasi me këtë rast partisë fituese i plotësohet kushti i domosdoshëm që ta ketë kandidatën për

kryeministër, por jo edhe i mjaftueshmi për ta krijuar vetë qeverinë dhe këtë duhet ta ketë parasysh LV-ja dhe jo të sillet sikurse të ketë fituar shumë më tepër sesa që ka deputetë. Po ashtu, kjo pamjaftueshmëri nuk duhet të keqpërdoret nga LDK-ja, pothuajse i barabartë me numër të deputetëve. Me këto sjellje të tanishme, LV-ja dhe LDK-ja i kanë humbur shumë pikë të besimit të qeverisë, nëse arrijnë marrëveshje për të", ka thënë ai.

Peci ka pohuar se nëse LV-ja dhe LDK-ja zgjedhin opsionin e zgjedhjeve të reja si rrugëdalje nga mospajtimet e tanishme, ato pikë së pari duhet ta dinë se nuk do të mund ta ofrojnë mesazhin e ndërrimeve dhe reformave në Kosovë pasi, sipas tij, do ta vetpërgjashtojnë njëra-tjetrën nga koalicioni i ardhshëm qeveritar. "Me këtë opsion ato do ta fusin vendin në krizë edhe me të thellë", ka deklaruar ai, duke theksuar se partneriteti ndërtohet me mirëbesim dhe me parashikueshmëri.

Edhe njohësi tjetër politik, Blerim Vela, ka reaguuar rreth situatës së krijuar së fundi në mes të LV-së dhe LDK-së. Ai ka thënë se lideri i LV-së dhe i LDK-së duhet t'i ulin gjakat e eksponentëve partiakë që po tentojnë të ngritën në karrierë me qëndrime ekstremiste. "Liderët duhet të tregojnë maturi dhe t'i kontribuojnë mirëbesimit për ndërtimin e koalicionit katër vjet plus. Arritja e marrëveshjes së tillë do të bëhet kur secila palë lëshon pe nga ambiciet personale të personave kyçë partiakë. Përderisa programi qeverisës është harmonizuar, tensionimi i raporteve për ndarjen e ministrive dhe presidentit është kthimi në politikën e vjetër të PDK-së", ka thënë Vela, duke pohuar se opsioni i zgjedhjeve të reja duhet të jetë alternativa e fundit.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Takimi i fundit në mes të liderit të Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti dhe liderit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, këtë të hënë kishte përfunduar me mospajtime sa i përket ndarjes së pushtetit, pasi LDK-ja ka kërkuar që pjesë e marrëveshjes të jetë edhe posti i presidentit të vendit. Tensionet mes këtyre dy partive janë rritur kur nënkryetari i LV-së, Glauk Konjufca, në emisionin "Pressing" në televizionin "T7" ka folur rreth kërkesave që LDK-ja i ka parashtruar LV-së për arritjen e marrëveshjes për koalicion qeverisës. "Marrëveshja për koalicion nuk u lidh sepse Lidhja Demokratike e Kosovës e kushtëzoi marrëveshjen për qeverinë, kuvendin dhe pozitën e presidentit", ka thënë Konjufca, duke theksuar se LV-ja nuk ka pritur që LDK-ja do ta kërkojë postin e presidentit pasi, sipas tij, këto ishin zgjedhje parlamentare. "Ne nuk e kemi pritur këtë gjë sepse, siç e dini, këto zgjedhje kanë qenë zgjedhje parlamentare dhe pas konsti-

tuimit del qeveria nga Kuvendi dhe pozita e presidentit është diçka krejt tjetër", ka thënë Konjufca.

Ai ka pohuar se edhe pse kanë dalë fitues të zgjedhjeve kanë bërë kompromise që të lidhin koalicionin me LDK-në. "Ne bëmë një kompromis dhe lejuam që Isa Mustafa ta zgjedhë i pari ministrinë që dëshirojnë. Ata zgjedhën pikërisht MPB-në", ka treguar Konjufca. Ai ka shtuar se LV-ja ka propozuar ndarjet ministrore në mënyrë të barabartë, por që presidenti të jetë i padiskutueshëm. "Ky është kompromisi ynë. Ndarja e ministrive 5 me 5 dhe kryeministri për kryeparlamentarin. Presidenti i padiskutueshëm", ka deklaruar nënkryetari i LV-së, Glauk Konjufca, i cili ka thënë se LV-ja i sheh si zgjidhje për dalje nga kjo situatë zgjedhjet e reja.

Për të mërkurën ishte paraparë të mbahej një takim i radhës në mes të Kurtit dhe Mustafës, por ky takim është anuluar. Po të mërkurën, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka reaguuar rreth ecurisë së bisedimeve me Lëvizjen Vetëvendosje. LDK-ja përmes një komunikate

Flet për "Epokën e re", Rrahman Jasharaj

Askush s'duhet të ndihet i liruar nga përgjegjësia për rezultatin në PISA

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës së Kosovës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se askush nuk duhet të ndihet i liruar nga përgjegjësia për rezultatin e dobët në PISA 2018. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se tani nuk duhet të humbet kohë duke gjetur fajtorë e duke bërë me gisht nga dikush tjetër. Jasharaj ka vlerësuar se duhet angazhim i përbashkët dhe krijim i një platforme kombëtare të arsimit. Sipas tij, me tabelë, shpuzë, shkumës dhe tekste të dobëta shkollore nuk mund të arrihen suksese të larta



të punës dhe shumë faktorëve të tjerë", ka deklaruar Jasharaj.

"Epoka e re": Z. Jasharaj, Kosova prapë është radhitur ndër vendet e fundit në testin ndërkombëtar PISA 2018. Cili është komenti juaj për këtë?

Jasharaj: Po, fatkeqësisht, edhe në PISA 2018 Kosova doli keq. Shpresonim se do të dilnim ndryshe duke parë mobilizimin që ishte bërë nga MASH-i, DKA-të, mësimdhënësit dhe nxënësit me qëllim që të shënojmë arritje më të larta, por ky është realiteti. Mendoj se nuk duhet bërë gabim, siç ndodh zakonisht në Kosovë, që të bëjmë me gisht nga ai tjetri dhe të mundohemi ta gjejmë fajtorin jashtë nesh. Duhet të ulemi të gjithë, Akademia e Shkencave e Kosovës, përfaqësues të universiteteve, sindikata dhe të tjerët që janë të ndërlidhur me arsimin dhe bashkërisht të shohim pse ndodhi kjo. T'i shohim tekste shkollore, kurrikulën, ta shohim pajisjen e shkollave me mjete të punës të cilat

mungojnë, sepse ende punohet në shumicën e shkollave me shkumës dhe shpuzë dhe me tekste shkollore që nuk janë të mira. Pa dashur t'i mbroj, unë kam parë nga afër, në vizitat e përditshme nëpër shkollat e komunave të Kosovës, se pjesa më e madhe e mësimdhënësve angazhohen për të arritur rezultate por, mbase, tërë ky mund po mbetet pa rezultate të duhura shkaku i shumë faktorëve dhe, mbase, po ua mësojmë nxënësve atë që nuk duhet, prandaj bashkërisht duhet të punojmë për një platformë kombëtare të arsimit në mënyrë që nxënësve t'ua mësojmë atë që u duhet dhe ashtu si duhet.

"Epoka e re": Kush mendoni se është përgjegjës për këtë rezultat të dobët?

Jasharaj: E thashë, askush nuk duhet të ndihet i liruar nga përgjegjësia, por nuk duhet as të humbim kohë duke gjetur fajtorë e duke bërë me gisht kah dikush tjetër. Na duhet angazhim i për-

bashkët dhe krijimi i një platforme kombëtare të arsimit. Na duhet angazhim dhe përkushtim i sinqertë i të gjithëve. Janë bërë shumë eksperimente në arsim tani e 20 vjet. Mësimdhënësit janë më së paku fajtorë në gjithë këtë. Atyre duhet t'u krijohen kushte për punë. U duhet ndihmuar me vizitat e inspektorëve profesionalë në orët mësimore për të parë cilat janë anët pozitive dhe çka duhet ndryshuar në punën arsimore dhe edukative të secilit mësimdhënës.

"Epoka e re": SBASHK-u po kritikohet për këtë rezultat, sepse vazhdimisht ka kërkuar rritje të pagave për mësimdhënësit, ndërkohë kjo rritje e pagave nuk po kthehet në rezultat?

Jasharaj: SBASHK-u nuk ka as edhe një faj. Ne kemi kryer obligimin tonë sipas Statutit të SBASHK-ut. Ne kemi obligim ta mbrojmë anëtarësinë tonë dhe të bëhemi zë i kërkesave të tyre. Kështu veprojnë sindikatat kudo në botë. Institucionet, deklarin në

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës së Kosovës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka deklaruar se të gjithë janë përgjegjës për rezultatin e dobët të Kosovës në PISA 2018. Ai ka vlerësuar se Kosovës i duhet një angazhim i përbashkët në këtë drejtim dhe krijimi i një platforme kombëtare të arsimit. "Askush nuk duhet të ndihet i liruar nga përgjegjësia, por nuk duhet as të humbim kohë duke gjetur fajtorë e duke bërë me gisht kah dikush tjetër. Na duhet angazhim i përbashkët dhe krijim i një platforme kombëtare të arsimit. Na duhet angazhim dhe përkushtim i sinqertë i të gjithëve", ka thënë Jashari. Ai ka mbrojtur mësimdhënësit, duke thënë se ata nuk janë fajtorë për këtë rezultat. "Janë bërë shumë eksperimente në arsim tani e 20 vjet. Mësimdhënësit janë më së paku fajtorë në gjithë këtë. Atyre u duhet krijuar kushte për punë. U duhet ndihmuar me vizitat e

inspektorëve profesionalë në orët mësimore për të parë cilat janë anët pozitive dhe çka duhet ndryshuar në punën arsimore dhe edukative të secilit mësimdhënës", është shprehur ai, duke shtuar se SBASHK-u nuk ka asnjë faj. "Ne kemi kryer obligimin tonë sipas statutit të SBASHK-ut. Ne kemi obligim ta mbrojmë anëtarësinë tonë dhe të bëhemi zë i kërkesave të tyre. Kështu veprojnë sindikatat kudo në botë. Institucionet deklarimin në publik, se arsimi është prioritet i shtetit, duhet ta kthejnë në vepër, duke ndarë me shumë mjete për arsimin, me qëllim që shkollat të jenë të përgatitura për kërkesat e shekullit 2", ka thënë ai. Sipas Jasharaj, me tabelë, shpuzë, shkumës e tekste të dobëta shkollore nuk mund të arrihen suksese të larta. "Po e them edhe një herë, duhet hequr dorë nga eksperimentet e vazhdueshme në arsim. Duhet krijuar platformë kombëtare të arsimit e jo të merren e huazohen praktika nga shtetet shumë të zhvilluara sepse ato praktika janë vështirë të zbatueshme në shkollat tona për arsye të kushteve

Tahiri: Ministria e Drejtësisë ka shënuar përparim në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka marrë pjesë të mërkurën në tryezën në të cilën është prezantuar projekti "Baza e të dhënave të rasteve të dhunës në familje", i cili është realizuar nga Zyra e Koordinatorit Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Me këtë rast, ministri Tahiri tha se Ministria e Drejtësisë për këto dy vjet ka pasur përparim substancial në parandalimin dhe trajtimin efikas të rasteve të dhunës në familje, ndërsa ka vlerësuar se baza e të dhënave të rasteve të dhunës në familje është e arritur e prekshme. "Kjo databazë shënon një ndër të arriturat e prekshme, që do të jetë në funksion afatgjatë

për zbatuesit e ligjit, mbështetjes psiko-sociale dhe shoqërisë në përgjithësi. Parametrat e saj do të diktojnë trendin, natyrën dhe do të përbejnë ftesë për veprim të menjëhershëm, për parandalim të dhunës, për trajtim adekuat psiko-social e ligjor të viktimave të dhunës në familje dhe, mbi të gjitha, për sensibilizim kombëtar kundër kësaj dukurie", tha ministri Tahiri.

Sipas ministrit Tahiri, kjo databazë nuk ka qëllim primar grumbullimin e të dhënave sa për t'i evidentuar ato, por edhe analizën shkak-pasojë në mes tyre, analizën e rasteve të dhunës në familje, rrjedhimisht, ndërtimin e një perspektivë më efektive që iu përgjigjet problemeve reale. "Prandaj, jam thëllësisht i bindur



se kjo databazë u jep dimension të ri përpjekjeve të institucioneve tona për parandalimin dhe trajtimin efikas të rasteve të dhunës në familje", tha ministri Tahiri. Ministri Tahiri tha se janë tri komponente që e bëjnë të mundur dhe që është punuar për trajtimin dhe parandalimin e dhunës në familje, duke filluar në rrafshin e drejtësisë penale ku, sipas tij, dhuna në familje është sanksionuar për herë të parë si vepër

penale në kuadër të Kodit të ri Penal. "Së dyti, në rrafshin e pozitës juridike të gruas janë bërë përparime të rëndësishme në të drejtat pronësore, për t'i dhënë fuqi ekonomike dhe pavarësi financiare dhe, së treti, në rrafshin e mobilitetit ndërinstitucional për të trajtuar çdo dimension të parandalimit dhe trajtimit të viktimave të dhunës në familje, komponent që po plotësohet me vënie në funksion të kësaj databaze", deklaroi ministri Tahiri. Para të pranishmëve ministri Tahiri tha se është obligim i pashmangshëm i secilit, qoftë bartësve të pushtetit dhe funksioneve institucionale, qoftë qytetarëve të këtij vendi, që të angazhohen që dhuna në familje të mos cenojë integritetin e gruas, fëmijëve dhe

viktimave të ndjeshme. Ndërsa zëvendësministrit i Ministrisë së Drejtësisë, njëherë Koordinator Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Naim Qelaj, tha se baza e të dhënave të rasteve të dhunës në familje është unike dhe origjinale në atë mënyrë që t'u përshtatet atyre zyrtarëve që do të punojnë në të. Të pranishëm në këtë organizim ishte edhe përfaqësuesja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Annette M. Fath Lihic, koordinatoreja e OKB-së për Zhvillim/UNDP, përfaqësuese e përhershme në Kosovë, Ulrika Richardson, përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përfaqësues nga KGJK dhe KPK, Policia e Kosovës, të cilët folën për rëndësinë e kësaj databaze.

publik, se arsimit është prioritet i shtetit, duhet ta kthejnë në vepër, duke ndarë me shumë mjete për arsimin, me qëllim që shkollat të jenë të përgatitura për kërkesat e shekullit 21 e jo të vazhdohet të punohet si në shekullin e shkuar. Me tabelë, shpuzë, shkumës e tekste të dobëta shkollore nuk mund të arrihen suksese të larta sado që pjesa më e madhe e mësimeve angazhohen. SBASHK-u nuk ka kërkuar rritje pagash, por ka kërkuar që sistemi arsimor në Ligjin e pagave të ketë vend meritore e jo të jetë i nënçmuar. Po e them edhe një herë, duhet hequr dorë nga eksperimentet e vazhdueshme në arsim. Duhet krijuar platformë kombëtare të arsimit e jo të merren e huazohen praktika nga shtetet shumë të zhvilluara sepse ato praktika janë vështirë të zbatueshme në shkollat tona për arsye të kushteve të punës dhe shumë faktorëve të tjerë.


"Epoka e re": Si sindikatë, a keni ndonjë plan se si të kontrollohet performanca e mësimeve në Kosovë?

Jasharaj: SBASHK-u ka qenë dhe mbetet kundër idesë së mbajtjes për testimin me shkrim të njohurive të mësimeve sepse ato njohuri janë testuar nga profesorët e fakulteteve gjegjëse. Ne e kemi thënë dhe vazhdojmë të kërkojmë që inspektorët profesionalë t'i vizitojnë shkollat tona dhe ta shohin nga afër punën arsimore edukative me nxënës të mësimeve tanë.

"Epoka e re": Keni paralajmëruar se do të hyni në grevë nëse Avokati i Popullit do ta dërgojë në Kushtetuese Ligjin për Paga. Sa do të ishte e drejtë hyrja në grevë në këtë kohë?

Jasharaj: Në takim me Avokatin e Popullit isha bashkë me kryetarin e Sindikatës së Shëndetësisë, Blerim Sylja dhe me kryetaren e Sindikatës së Policisë, Valbona Kamberi. E kemi informuar Avokatin e Popullit lidhur me situatën që është krijuar mes anëtarësisë së këtyre tri sindikatave pasi është thënë dhe është dëgjuar se ai, mbase, do ta dërgojë Ligjin e Pagave në Kushtetuese. SBASHK-u fillimisht kishte bërë angazhime të shumta që Projektligji për pagat të tërhiqej dhe të ulerin të gjitha palët e ta përgatitin si duhet sepse, e kemi thënë shumë herë dhe publikisht, se Projektligji ishte i dobët dhe, për sistemin arsimor, degradues dhe nënçmues. Por, kjo nuk u bë dhe u desh shumë angazhime të tjera të bëjmë, pastaj edhe grevë, për t'i ndryshuar koeficientet. Njerëzit kanë qenë në pritje që Ligji për Pagat të nisë të zbatohet me pagën e dhjetorit dhe ia kemi thënë Avokatit të Popullit se nëse kjo nuk ndodh atëherë mund të ketë reagime dhe veprime. Unë, si gjithmonë, do ta respektoj zërin e punëtorëve të tërë sektorit të arsimit dhe ashtu si vendos Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, në të cilin janë përfaqësuesit e tërë sektorit të arsimit, nga çerdhet, arsimit parauniversitar dhe universitetet. Do të veproj ashtu si kërkojnë ata.

JEMI TË TRONDITUR



REXHEP QOSJA

1. Jemi të tronditur. Të gjithë. Jemi të tronditur, me shpirt e me mendje. Të gjithë. Të tronditur në këto ditë para e gjatë Ditës sëmadhe në historinë tonë- Ditës së Flamurit kombëtar e shpalljes së Shqipërisë shtet. Të gjithë. Të tronditur për shkak të gjithë atyre viktimave, të gjithë atyre plagosurve, të gjithë atyre traumave që nuk kalojnë lehtë e shpejtë, për shkak të gjithë atyre dëmeve të mëdha lëndore, ekonomike, shoqërore e kulturore. Jemi të tronditur për shkak të tragjediave që pësuan nënën, fëmijët, vajzat e reja e djemtë e rinj, në lule të rinisë. Tronditja e shkaktuar kësaj here prej tërmetit të 26 nëntorit është tronditje që zgjat shumë. Dhe, zgjat shumë për shkak se pushton ndjenjat, pushton shpirtin, pushton ndërgjegjen e gjithë atyre që mendojnë përgjegjësisht. Kjo është tronditje në të cilën përmbledhen ndjenja e mendime për historinë, për bashkëkohësinë dhe për ardhmërinë tonë, por edhe për historinë, bashkëkohësinë, ardhmërinë në përgjithësi. Kjo tronditje na nxit të vetëpyetemi: A kemi mësuar krejt çka duhej prej historisë? A e kemi vështruar dhe kuptuar sa e si duhet bashkëkohësinë? A kemi menduar largpashëm për ardhmërinë?

2. Në këtë gjendje tronditjesh mund të jesh i pushtuar edhe prej mendimesh kundër natyrës dhe me mendime të tilla t'i drejtohesh asaj: Natyrë! Natyrë! Natyrë e mrekullueshme në këtë planet që i thonë Tokë, Tokë me bukuri të jashtëzakonshme që nuk mund të merren me mend në asnjë planet a trup tjetër qiellor. Na e ke bërë të mundshme jetën në hapësirat tua tokësore, ujore e ajrore. Pse kohë pas kohe po na e helmon jetën edhe me tragjedi, me tronditje, me pikëllime. Përpos prej njerëzve, popujve, shteteve, fatkeqësitë, tronditjet po na vijnë edhe prej teje, Natyrë?! Dhe po na vijnë me padrejtësi. Hajde e mos e shpreh këtë mendim që nuk mund të mos

thuhet këto ditë zie, kur i sheh arkivolet e tragjedisë dhe të pamëshirës natyrore!

Hajde e mos i shpreh këto mendime kur i sheh arkivolet dhe i dëgjon fjalët e medieve për tragjeditë qëu mbyllën në ato arkivole:

Për tragjeditë e familjes Lala, të cilën e përbënte edhe Nëna me katër fëmijët, mes të cilëve binjakët dyvjeçarë, ndoshta ende duke u mësuar nga qumështi i nënës.

Asnjë fjalë, asnjë figurë, asnjë mendim, asnjë pamje nuk është e mjaftueshme për të përshkruar, për të paraqitur gjithë tronditjen që na shkaktoi pamëshira tragjike me të cilën natyra e dënoi këtë nënë me katër fëmijët e saj, me binjakët e saj! Dhe të tjerët bashkëviktima me ta. Hajde e mos i shpreh këto mendime kur i sheh arkivolet në të cilat u mbyllën tragjeditë e anëtarëve tëfamiljeve Cara, Ndreu, Gregu, Vata, Reçi, Meçja. E tjetra, tragjeditë e të cilave na e copëtojnë zemrën.

Hajde mos i shpreh këto mendime kur i sheh arkivolet e dy vëllezërve kosovarë, Abazi, të valltares, të piktores, të studentes që donte të studionte arkitekturën e bëhej mjeke, të të rinjve të tjerë e tërejave të tjera që nuk pritën të provojnë të mirat e gëzimet që sjell pjekuria! Por, hajde e mos e thuaj edhe një mendim tjetër qëkë krejt nuk do e ngre kundër shqiptuesit të këtij mendimi: tronditjes që na ka pushtuar i kanë kontribuar disa njerëz, disa nga ata njerëz të zgjedhur gjatë 30 vjetëve tona për të krijuar institucionet e për të ngritur ekspertët që do të merreshin me të priturat e me tëpapriturat që mund të na sillte kur natyra e pamëshirshme e kur njëmendësia e keqkuptuar. Dhe, këta njerëz i quajmë politikanë e shtetarë!

3. Në këto ditë tronditjesh unë nuk mund të mosmendoj edhe për ato që kam parë e kam dëgjuar që tridhjetë vjet në jetën partiake, politike, shtetërore shqiptare. E ato që dëgjoja dhe ato që shihja gjatënjëzet e katër orëve të ditës e të natës ishin e janë mosmarrëveshjet, zënkat, konfliktet, mosdurimet,urrejtjet e ndërsjella të forcave politike, në radhë tëparë të prijësve politikë dhe të argatëve të tyre. Deri në ditën e tërmetit tragjik nuk gjendej arsye, nuk gjendej mjet, nuk gjendej qëllim kombëtar, shoqëror, shtetëror a moral, më në fund njerëzor, qëprijësit partiake e shtetërorë të këtyre tridhjetë vjetëve do t'i bënte e do t'i detyronte, më në fund, tëmerreshin vesh. Jo. E mosmarrëveshjet e tyre, mosdurimet e tyre,zënkat e tyre, kon-

fliktet e tyre, privilegjet e tyre dhe lukset e tyre janë ndër arsytet e degdisjes së gati dy milionë shqiptarëve nga Shqipëria e Kosova në Botëgjatë10-15 vjetëve të fundit!

Tani, përnjëherë, pas tërmetit, pas fatkeqësisënatyrore, u pajtuam: gjetën atë që as këta e as ata paraardhësit e tyre nuk e gjenin kurrsesi më parë: u pajtuam!

Dhe, ai, kryetari partiake që qe sa vjet në Shqipëri, në Kosovë, në Ballkan, në Evropë e në SHBA flet vetëm për më të këqijat, më të ulëtat, më të poshtrat, më të zezat, më të krimshmet e Shqipërisë në politikën e atyre ndaj të cilëve është në opozitë, përnjëherë tha: me gjithë ndasitë që kemi, në nevojë jemi një komb!Por, Por!

Mendja e tij na mësoi se vetëm në nevojë, e jo edhe në tragjedi, vetëm në nevojë e jo edhe në gëzime, në nevojë e jo edhe në varfëri, jemi komb, jemi njëkomb!

Dhe kjo fjalë megjithatë shumë shpejt u botua nërrjetet sociale të kundërshtarit politik - të të sulmuarit pa pushim shumëvjeçar!

Dhe, kështu u pajtuam! I pajtoi tragjedia e tëvarfërve! I pajtoi tragjedia e tëshpërfillurve. I pajtoi tragjedia e të konsideruarve të tepërt! Por u pajtuam rrejtshëm. Mund të them siç po them se pikërisht tani kur këta rreshta po i qes në shkrimin tim po dëgjoj sulmet e dy Sulmuesve të pandalshëm ndaj të Sulmuarit tëgjithnjëshëm - kryeministrit Edi Rama! Dhe, po i shoh Sulmuesit duke u sjellë ndaj pasojave tragjike tëtërmetit si qeveri e dytë e Shqipërisë, që e shpërfill, s'e pranon Qeverinë që zgjodhi populli! Dhe, Shqipëria e Abdyl Frashërit, Vaso Pashës e Ismail Qemalit na bëhet Shqipëri me dy qeveri të papajtueshme në ditët paskajshëm pikëlluese, tronditëse në historinë e saj!

4. Dua të shpresoj, dua të besoj se pas tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019 populli shqiptar do të jetë forcëpolitike me sy, me të cilët do të shohë më qartë se deri tash, forcë politike që e sheh qartë, që e kupton qartëgjendjen e vet, që e mendon qartë ardhmërinë e pasardhësve të vet, që mendon jo vetëm për premtimet e të priturat, si deri tani, por edhe për të papriturat natyrore, politike, shtetërore. Njëmendësia aq e prituri, aq e ëndërruar, aq e dëshiruar na ka sjellë edhe shumë të papritura e shumëdëshpërime gjatë këtyre tridhjetë vjetëve. Na e solli edhe "qeverinë" e dytë në ditët më dhembjesjellëse! Por, nuk jam pesimist. Pesimist nuk mund të më bëjnë

ata që postet politike i shfrytëzojnë për t'u qëndisur me miliona duke shfrytëzuar postet politike, ata që postet politike ishfrutëzojnë për t'u stolisur me vila në Gjirin e Lalzit e përgjatë bregdetit, në Brezovicë e Prevallë. Dhe jo vetëm. Jo. Kurrë.

Pas tronditjes sado e gjatë qoftë, që solli tërmeti,fatkeqësia, megjithatë, do të bëhet nxitje për forcim, për ngritje shpirtërore, etike, shoqërore, kombëtare, shtetërore.

Populli shqiptar, përpos gjatë këtyre tridhjetëvjetëve tranzicion, kurrë, në asnjë epokë a periudhëhistorike, nuk ishte pa figura historike si Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Jeronim De Rama, Konstandin Kristoforidhi, Pashko Vasa, Hoxha Tahsini, Jani Vreto, Abdyl Frashëri, Sami Frashëri, Naim Frashëri, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Isa Boletini, që politikën e përdorën jo duke u pasuruar prej saj po duke u flijuar për Shqipërinë e për shqiptarët.

Durrësi, më i dëmtuari në tërmetin e 26 nëntorit, do ta marrë veten. Shumë tërmete ka përjetuar Durrësi: më 177 para erës sonë, më 334, 506, 1273, 1869, 1870, 1926, 1979... dhe shpejt e ka marrë veten. Ishte qytet i dëshiruar edhe prej të huajve, prej miqve dhe prej pushtuesve. Takimet me popuj të tjerë e kanë pasuruar kulturën e tij e qytetërimin e tij dhe e kanë shtuar lavdinë e tij historike e kombëtare. Fatkeqësinë e fundit natyrore, si edhe herët e tjera, Durrësi do ta përballojë, do ta mundë me dhuntinë e tij të madhe jetëkrijuese, gjallëruese ndërtimore e gjithëkombëtare.

Në sajë të dhuntive të Durrësit, në sajë tësolidarisë që treguan bashkatdhetarët kudo që janë sot e, sidomos, Kosova, shqiptarët e goditur prej tërmetit do të kenë gatishmëri e do të dinë të zbatojnëmësimet e rilindësve të mëdhenj të cilët me gjithësakrificat e pamatshme e bënë Shqipërinë dhe e bënëshqiptarin: më të fortë, më të ngritur e më të zhvilluar në të gjitha pikëpamjet. Fatkeqësia e 26 nëntorit do të përfundojë mefuqizim të përgjithshëm të shqiptarëve: të mundësive ndërtuese e krijuese. E kuptueshme. Nuk është thënë pa dëshmi shumëshkollore se dhembjet e vuajtjet i bashkojnënjerëzit më shumë se gëzimet.

E tani për tani më e rëndësishmja është: të jemi - të gjithë me Durrësin, me Tiranën, me Thumanën e tëgjitha qytetet, qytezat, fshatrat që i dëmtoi tërmeti, tëjemi me ta me çka kemi, me çka mundemi e me çka dimë. Se ashtu do të jemi me shtetin amë, Shqipërinë, me Kosovën, me gjithë bashkëkombëtarët kudo ndodhen ata.

Prishtinë 26-29 nëntor 2019

KDI-ja: Ka ardhur koha për ligjin për lobim në Kosovë

"Vendosja e rregullave të qarta për lobim është hap i rëndësishëm për forcimin e transparencës dhe kornizës ligjore për luftimin e korrupsionit, andaj vendosja e një kornize ligjore është pjesë e rëndësishme e shoqërisë moderne demokratike. Lobimi i rregulluar me ligj rrit transparencën në sektorin publik dhe rregullon marrëdhëniet midis grupeve të ndryshme të interesit, lobistëve, mbajtësve të zyrës publike dhe politikanëve, që kontribuon në funksionimin më të mirë të administratës shtetërore", ka thënë Arben Kelmendi, menaxher i programit në KDI-së, me rastin e publikimit të raportit "Legjislacioni i porositur: A ka ardhur koha për Ligjin për Lobim në Kosovë?"



të shkallës së përhapjes së dukurisë së ashtuquajtur "legjislacioni i porositur" në rajonin e Ballkanit dhe lidhjeve të mundshme ndërmjet rasteve të ngjashme në këto shtete. Ky legjislacioni i përpiluar dhe miratuar për t'u shërbyer interesave të caktuara të një personi apo rrjeti të ngushtë të personave të lidhur në një sektor si një praktikë e tillë, ka thënë se është korruptive dhe synim kryesor e ka "legalizimin e korrupsionit", duke u siguruar "mburojë ligjore" veprimeve të tilla negative. "Instituti ka analizuar disa akte ligjore dhe nënligjore si raste të dyshimta të legjislacionit si: projektligjin për financimin e subjekteve politike, projektligjin për lirinë e asociimit, udhëzimin administrativ për homologimin e automjeteve dhe udhëzimin administrativ për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shën-

detësore publike", ka shtuar ai. Sipas Kelmendit, të gjitha studimet serioze në fushën e kudnëkorrupsionit pajtohen në një gjë: një fije shumë e hollë ndan aktivitetet legjitime të lobistëve gjatë procesit legjislativ dhe presionin që grupet e caktuara të interesit ushtrojnë mbi vendimmarrësit për ta kaluar legjislacionin që u shërben interesave të tyre. "Vendosja e rregullave të qarta për lobim është hap i rëndësishëm për forcimin e transparencës dhe kornizës ligjore për luftimin e korrupsionit, andaj vendosja e një kornize ligjore është një pjesë e rëndësishme e shoqërisë moderne demokratike. Lobimi i rregulluar me ligj rrit transparencën në sektorin publik dhe rregullon marrëdhëniet midis grupeve të ndryshme të interesit, lobistëve, mbajtësve të zyrës publike dhe politikanëve, gjë që kontribuon në funksionimin më të mirë të administratës shtetërore", ka thënë Kelmendi. Përvojat e vendeve në Ballkan tregojnë se zbatimi i mirëfilltë i këtyre ligjeve kërkon një kohë të caktuar për zbatim në praktikë. Ai ka treguar se në Maqedoni

aktivitetet e organizatave joqeveritare dhe grupeve të qytetarëve kanë luajtur rol të rëndësishëm në miratimin, por edhe në ndryshimin e mëvonshëm të ligjit për lobim, kurse në Slloveni dhe Mal të Zi ky ligj është treguar pjesë e rëndësishme e kornizës ligjore për luftimin e korrupsionit në procesin e vendimmarrjes publike. Kelmendi ka vlerësuar se lobimi është veprimtari i ligjshme dhe pjesë e rëndësishme e procesit demokratik. Në një shoqëri demokratike gjithmonë ekziston interesi publik për të siguruar proces lobimi transparent dhe me integritet të plotë. Instituti Demokratik i Kosovës vlerëson se në Kosovë janë pjekur kushtet që kjo fushëveprimtari të definohet qartë me kornizë ligjore dhe propozon rekomandimet në vijim të cilat do të duhej t'i kishte parasysh iniciativa për përpilimin e ligjit: Instituti Demokratik i Kosovës, pas konstituimit të Kuvendit dhe formimit të qeverisë së re, do ta vazhdojë komunikimin me krerët institucionale dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm me qëllim të sigurimit të përkrahjes për këtë iniciativë ligjore, por edhe për nisma të tjera që i konsiderojmë të rëndësishme për zhvillimin e demokracisë në Kosovë. Ky raport publikohet në kuadër të Iniciativës "Kuvendi 2020" - një platformë bashkëbisedimi në mes të përfaqësuesve politikë dhe shoqërisë civile për t'i rritur transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e institucioneve të Kuvendit.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Zyrtarë të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) kanë mbajtur të mërkurën konferencë për media, gjatë së cilës është publikuar raporti i shkurtër "Legjislacioni i porositur: A ka ardhur koha për Ligjin për Lobim në Kosovë?" Me këtë rast, Arben Kelmendi, menaxher i programit në KDI, ka theksuar se korrupsioni, si formë e keqpërdorimit të pushtetit të besuar për interesa personale, konsiderohet sfida më e madhe me të cilën ballafaqohet shoqëria e Kosovës në përpjekjet e saj për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Kelmendi ka informuar se KDI-ja po zbaton projekt të bashkuar me pesë shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor që ka si objektivi edhe të kuptuarit drejt

asistencën e duhur për riintegrimin dhe rehabilitimin e këtyre personave. Gjithashtu, ministri Mustafa ka thënë se në këtë proces po japin kontribut të çmuar mekanizmat ndërkombëtarë. Më pas u diskutua lidhur me çështjen e sigurisë, me theks të veçantë të sigurisë në trafik. Lidhur me këtë temë ministri Mustafa ka theksuar se është shumë shqetësues shtimi i aksidenteve në trafik, të cilat shpeshherë përfundojnë me fatalitet. "Kjo çështje është shumë shqetësuese dhe është koha e fundit që institucionet të veprojnë konkretisht për zvogëlimin e këtij problemi", është shprehur ai, duke shtuar se përgjegjësia kryesore bie mbi institucionet e vendit, por edhe shoqërisë në përgjithësi. Në anën tjetër, zëvendësbasadori i misionit të OSBE-së

MPB-ja mban takim me kryetarët e komunave, shqetësues shtimi i aksidenteve në trafik

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka mbajtur të mërkurën takim me kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, ministri Mustafa ka theksuar se ky takim është i një rëndësie të veçantë sepse krijon mundësi për dëgjimin e të arriturave dhe sfidave nëpër komunat e Republikës së Kosovës. Fillimisht, temë diskutimi ishte procesi i riadhesimit dhe riintegrimin të qytetarëve të kthyer nga Siria.

Ministri Mustafa para të pranishmëve ka bërë me dije se Ministria e Punëve të Brendshme, në përkrahje të institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës, të përfshira në këtë proces, ka dhënë

asistencën e duhur për riintegrimin dhe rehabilitimin e këtyre personave. Gjithashtu, ministri Mustafa ka thënë se në këtë proces po japin kontribut të çmuar mekanizmat ndërkombëtarë. Më pas u diskutua lidhur me çështjen e sigurisë, me theks të veçantë të sigurisë në trafik. Lidhur me këtë temë ministri Mustafa ka theksuar se është shumë shqetësues shtimi i aksidenteve në trafik, të cilat shpeshherë përfundojnë me fatalitet. "Kjo çështje është shumë shqetësuese dhe është koha e fundit që institucionet të veprojnë konkretisht për zvogëlimin e këtij problemi", është shprehur ai, duke shtuar se përgjegjësia kryesore bie mbi institucionet e vendit, por edhe shoqërisë në përgjithësi. Në anën tjetër, zëvendësbasadori i misionit të OSBE-së



në Kosovë, Kilian Wahl, ka pohuar se si mision kanë mbështetur themelimin dhe punën e forumeve lokale dhe komunale të sigurisë, në mënyrë

që të ndërtohet një mekanizëm solid i besimit, respektimit dhe lidhshimit të mirë në kuadër të policimit në komunitet dhe bashkësi. Ai ka thënë se Policia e

Kosovës vitet e fundit ka kontribuar drejtpërdrejt për rritjen e sigurisë të qytetarëve të Kosovës dhe se niveli i besimit të PK-së qëndron 61 për qind, që është një besim i madh krahasuar me vendet fqinje. "Shpresojmë se kjo përqindje të rritet edhe më tej. Duhet t'i rrisim përpjekjet tona që ta përmirësojmë sigurinë dhe këtë ta bëjmë si përmes këshillave lokale të sigurisë në bashkësi dhe përmes këshillave komunale të sigurisë në bashkësi", ka thënë ai.

Në fund, drejtori për Siguri Publike i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Mensur Hoti, bëri një përmbledhje të përgjithshme të konferencës dhe vuri në dukje për format se si do të duhet të organizohen konferencat e ardhme me kryetarët e komunave.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka vizituar kazermën "Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë

Meta dekoron shpëtimtarët e Kosovës për ndihmën e dhënë pas tërmetit

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka ndarë të mërkurën medalje për ushtarët e FSK-së, policët dhe zjarrfikësit e Kosovës, të cilët u kanë dalë në ndihmë zonave të Shqipërisë të prekura nga tërmeti shkatërrues i 26 nëntorit. "Të dashur shpëtimtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë të cilët u paraqitët në orët e para të një beteje midis jetës dhe vdekjes, nuk ka vlerësim më të mirë sesa t'ju quaj shpëtimtarë të gjithë juve", ka thënë Meta



opozitë, që të ngritën mbi interesat parciais dhe t'u dalin në ndihmë të gjithë atyre njerëzve që kanë zi sot dhe frikë për të nesërmen", ka thënë Haradinaj. Në fjalën e tij, ai ka theksuar se të gjithë janë krenarë dhe mburren me profesionalizmin e ushtrisë së Kosovës.

Ai ka vlerësuar lart kontributin e të gjitha njësive nga Kosova që u dolën në ndihmë bashkëkombësve të tyre në Shqipëri, duke theksuar se Kosova reagoi si shtet me të gjitha resurset humane, teknologjike dhe financiare, që në orët e para të mëngjesit të 26 nëntorit fatal, me ushtrinë dhe policinë e saj, me njësitet e kërkim-shpëtimit dhe emergjencave civile. "Në të njëjtën ditë në Shqipëri janë nisur ekipet e Çetave të Shpëtimit të Trepçës dhe Artanës: Njësia e Zjarrfikësve nga Korporata Energjetike e Kosovës, nga Komuna e Suharekës, kompanitë e mirëmbajtjes së rrugëve të kontraktuara nga Ministria e Transportit, që dua t'i falënderoj nga zemra, duke u thënë: Bravo ju qoftë!", ka thënë Haradinaj.

Kurse komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rahman Rama, ka thënë se është nder dhe kënaqësi marrja e këtyre dekoratave, pasi është vlerë për të gjithë, jo veç për FSK-në, por nder dhe privilegj për Kosovën. "Ne nuk kemi bërë asgjë më shumë se kemi kryer detyrën tonë, se çfarë bën vëllai për vëllanë, Kosova po e dëshmon çdo ditë se jemi të gatshëm t'i përkrahim të gjithë fqinjët tanë, në interes të sigurisë rajonale", ka deklaruar Rama.

Me motivacionin për forcimin e bashkëpunimit Kosovë - Shqipëri, kryeministri në detyrë, Haradinaj, i ka ndarë presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, medaljen "Gjergj Kastrioti Skënderbeu".

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

Shqipërisë të prekura nga tërmeti shkatërrues i 26 nëntorit.

Presidenti Meta ka ndarë Dekoratën e Artë të Shqiponjës për Task-Forcën e FSK-së dhe Dekoratën për Merita të Veçanta për njësitin K-9 të FSK-së. Me këtë rast, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka falënderuar FSK-në për reagimin e shpejtë për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve të

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka vizituar kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Prishtinë. Meta ka ndarë të mërkurën medalje për ushtarët e FSK-së, policët dhe zjarrfikësit e Kosovës të cilët u kanë dalë në ndihmë zonave të

prekur nga tërmeti i 26 nëntorit, në Durrës dhe Thumanë. "Të dashur shpëtimtarë të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Policisë të cilët u paraqitët në orët e para të një beteje midis jetës dhe vdekjes, nuk ka vlerësim më të mirë sesa t'ju quaj shpëtimtarë të gjithë juve", ka thënë Meta.

Ai ka deklaruar se në këtë betejë të vërtetë, me një bilanc të rëndë, Shqipëria nuk mbeti e vetme. Sipas presidentit shqiptar, ushtarët e FSK-së kanë rrezikuar jetën për të shpëtuar jetë të tjera. "Shumë vende mike dhe partnere bënë më të mirën e mundur për të na u gjendur pranë sa më shpejt të ishte e mundur. Por, Kosova ishte e para që u ndodhë atje menjëherë në luftën për ta shpëtuar jetën e çdo shqiptari nën rrënojat e katastrofës. Ekipet tuaja nuk ishin atje vetëm fizikisht e profesionalisht, por në radhë të parë njerëzisht, vëllazërisht e shqiptarisht, duke rrezikuar jetën e tyre për të shpëtuar shumë jetë të tjera", ka deklaruar Meta, duke potencuar se populli shqiptar do të jetë përgjithmonë

mirënjohës për solidaritetin, profesionalizmin dhe gatishmërinë e jashtëzakonshme.

Ai ka vlerësuar se Kosova duhet të jetë krenare për Forcat e Sigurisë, për të shtuar se çdo vend i NATO-s do të ishte i kënaqur me atë që ka shfaqur FSK-ja gjatë ditëve të kërkim-shpëtimit në Shqipëri, pas tërmetit të fuqishëm që goditi vendin. Gjithashtu, presidenti Meta Njësia Speciale Operative të Policisë së Kosovës i ka ndarë titullin "Kalorës i Urdhrit të Flamurit", ndërkaq Njësitit të Çetës së Shpëtimit-Miniera e Trepçës, Çetës së Shpëtimit-Miniera e Artanës, ekipit të Zjarrfikësve (KEK), Njësia të Zjarrfikësve të Komunës së Suharekës ua ka ndarë titullin për Merita të Veçanta Civile.

Në këtë ceremoni ka folur edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se Kosova dhe Shqipëria janë unike si kurrë më parë dhe s'ka tërmet që i ligështon. "Ne jemi unikë si kurrë më parë, Kosovë e Shqipëri, veri e jug, të majtë e të djathtë, pushtet e



Punëtorët shëndetësorë presin që në fund të muajit t'i marrin pagat me rritje

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Me ftesë të Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, të mërkurën është mbajtur një takim i Bordit Drejtues me drejtorët e institucioneve shëndetësore që janë në varësi të ShSKUK-së, Federatën Sindikale të Shëndetësisë dhe Odën e Mjekëve të Kosovës. Pikë

vetme e rendit të ditës ishte diskutimi në lidhje me fillimin e zbatimit të Ligjit të ri për Paga, i cili ka filluar të zbatohet nga data 1 dhjetor.

Qëndrim i përbashkët i të pranishmëve ishte se ky ligj është i mirëseardhur për të gjithë profesionistët shëndetësorë dhe se presin që në fund të këtij muaji punëtorët shëndetësorë t'i marrin pagat me rritje. Në takim u tha se tendencat për ta pezulluar

zbatimin e këtij ligji janë të papranueshme dhe kanë për qëllim ta dëmtojnë përparimin e arritur në drejtim të përmirësimit të përgjithshëm të mirëqenies së punëtorëve shëndetësorë.

Institucionet e pranishme në takim u kanë bërë thirrje të gjitha institucioneve vendimmarrëse të jenë të kujdesshme dhe mos ta pengojnë zbatimin e këtij ligji për interesa të grupeve të ndryshme.



Termi paramilitar përdoret gabimisht nga mediat tona



Nga Jakup KRASNIQI

Më 4 dhjetor 2019 në RTK, në orën 9:00 të mëngjesit, u dha lajmi për një varrezë masive të shqiptarëve "të vrarë në luftë nga paramilitarët serbë"? Lajmi jo vetëm që nuk është i saktë, por ishte edhe krejt i gabuar.

Pse? Krimet e luftës që janë kryer në Kosovë janë edhe krime të gjenocidit ndaj shqiptarëve. Ato vrasje nuk janë bërë nga paramilitarët, por nga instrumentet e shtetit serb dhe politika e planifikuar e Serbisë për ta shuar pjesërisht ose tërësisht popullin shqiptar në Kosovë. Madje, për ato krime të gjenocidit, politika zyrtare serbe as sot e kësaj dite nuk është distancuar as formalisht. Përkundrazi nga zyrtarët më të lartë të atij shteti edhe sot e kësaj dite drejtohen kërcënime

ndaj shqiptarëve dhe Republikës së Kosovës. Ata edhe sot përpiqen ta pengojnë çdo formë të bashkëpunimit ekonomik ndër shqiptar si edhe vetë ekzistencën e shtetit tonë të pavarur, sovran e demokratik. As ata të vjetrit e as këta të rinjtë sot nuk janë e as ishin grupe që vepruan e vepronin jashtë politikës zyrtare të Serbisë. Paramilitarët ishin krijesa të shtetit me qëllim që të amnistoheshin instrumentet e shtetit. Prandaj askush në Kosovë nuk duhet ta

hajë atë karrem të krijuar nga politika zyrtare e gjenocidit serb.

Shkurt, kur thua vrasje nga paramilitarët, nuk ke thënë asgjë dhe ke akuzuar hiçgjë. Çdo vrasje në Kosovë është bërë nga Serbia, nga instrumentet shtetërore të krijuara e të ekzistuar për atë qëllim, të bënin krime të gjenocidit. Dhe ata e bënë këtë dje dhe nuk janë penduar as sot.

Çdo term tjetër i përdorur për ato vrasje është i gabuar! Siç është i gabuar edhe përdorimi i termit masakër i cili në asnjë

mënyrë nuk mund t'i zëvendësojë krimet e gjenocidit që i përjetuan shqiptarët disa herë nga Serbia, filluar me gjenocidin serb të viteve 1876/78, Luftës së Parë e të Dytë Botërore e ato të viteve 1998/99.

Se si do të duhej të përdoshin këto terme, para ca ditësh, në hollësi ka sqaruar e argumentuar në mediat tona, politologu ynë Bardhyl Mahmuti.

Saktësia gjuhësore dhe përdorimi i saktë i termave politike është kulturë edhe për ata që informojnë e informohen.

Reflektim për PISA



Prof. Asoc. Dr. Arben DËRMAKU

Sot u njohëm me rezultatet e vlerësimit ndërkombëtar PISA ku Kosova renditet e treta prej fundit. Po shikoj reagimet në rrjetet sociale dhe po shoh një tendencë të kalimit të fajit te pala tjetër për këtë gjendje dhe "sukses". Unë pajtohem me vlerësimin dhe me metodat e përdorura në këtë vlerësim sepse janë të dizajnuara nga ekspertë të fushës. Derisa nuk pajtohem me konstatimin se nxënësit janë të dobët ose mesimdhënësit janë të dobët ose prindërit janë fajtorë.

Nxënësit janë shembulli më i mirë i suksesit në rastet e largimit të tyre në një sistem arsimor të zhvilluar. Posa të ndodhë faza e adaptimit të nxënësit kosovar në ambientet e reja të sistemeve arsimore të zhvilluara pason sukcesi i tyre, prandaj të thuhet se nxënësit janë të dobët është diçka e verifikuar që nuk qëndron. Mesimdhënësit janë të dobët, edhe kjo thënie nuk gjen vend për faktin se pikërisht këta mesimdhënësit kur dalin jashtë dhe punojnë në sistemet e avancuara arsimore dalin si të suksesshëm. Kur flasim për totalin normalisht se ka përfjashime që i shkojnë për shtati thënies së fillimit të këtij paragrafi. Nuk është se dua t'i amnistoj të gjithë, por situata është e verifikueshme lehtë. Prindërit janë fajtorë, kjo thënie absolutisht është e

papranueshme për faktin se prindërit janë ata që kanë dëshmuar se janë në kërkim të së mirës për fëmijët duke investuar edhe euron e fundit për kurset dhe qëndrimet ditore të tyre. Prindërit në shumicën absolute janë duke asistuar mesimdhënësit duke ndihmuar fëmijët në kryerjen e detyrave të shtëpisë e të klasës. Kjo situatë është e mjerueshme për faktin se prindërit po luajnë rolin e mesimdhënësit, kurse mesimdhënësit po luajnë rolin e prindërit.

Pas këtij reflektimi shtrohet pyetja normale ku qëndron problemi?

Problemi është në sjelljen e përgjegjësve dhe interesantëve të arsimit ndaj gjendjes reale në këtë sektor. Qitet pluhur syve se

ne po investojmë në trajnimin e stafit ku shpenzohen qindra miliona euro, por efektet po shihen. Pra, problem është sistemi arsimor që ofrojmë në Kosovë, term ky i përdorur shpesh pa elaborim të mëtejshëm të shkaqeve të shkoqitura. Në vazhdim po prezantoj shkaqet e gjendjes jo të mirë në arsimin e Kosovës:

- Mësimi tërëditor është parakusht themelor i karakterit teknik dhe përmbajtjesor për të arritur te ndryshimi i avazit të vjetër. Është për keqardhje reagimi i sindikatës në lidhje me këtë problematikë duke manipuluar rëndë me opinionin publik.

- Përcaktimi i modelit të sistemit arsimor të suksesshëm për t'u implementuar në rastin e Kosovës. Mos të aplikohen reforma të segmentuara nga shtete të ndryshme, por të

aplikohet një model për të tëra nivelet e edukimit në Kosovë. Kjo është e lehtë të përcaktohet dhe të bëhet një implementim i kopjimit dinjitoz duke përfshirë të gjitha proceset në kuadër të sistemit arsimor (për më shumë shih shtegu i arsimit parauniversitar).

- Ndërtimi i llogaridhënies përmes masave atraktive të delegimit të detyrave mesimdhënëse që kanë për detyrë të përmbushin gjatë një ore mësimore. Do të duhej të shfrytëzohet media për të bartur metodat e mesimdhënies deri të mësuesi i fundit që punon me nxënës. Etj. Shpresoj të jem një zë artikules në kuadër të shqetësimeve që kemi në lidhje me sistemin arsimor në Kosovë.

(Autori është profesor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit "Hasan Prishtina")

Drejtori i Policisë merr pjesë në një simpozium në ShBA me temë ekstremizmin

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, me bashkëpunëtorë, është duke qëndruar në një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Washington D. C., ku po merr pjesë në simpoziumin "Policimi i orientuar në komunitet, me theks të veçantë në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm". Drejtori Qalaj në këtë simpozium në të cilin marrin pjesë nivele të larta udhëheqëse është panelist në diskutimet përmbledhëse lidhur me programet preventive "Reagimi ndaj radikalizmit të rinjve".

Ky simpozium, në të cilin po merr pjesë edhe Policia e



Kosovës, është organizuar nga organizatat e njohura Hedayah

dhe Global Center, të cilat kanë për mision trajtimin, luftimin si

dhe zhvillimin e praktikave më të mira që ndërlihen me

dukurinë e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Fillon dorëzimi i mjeteve dhe pajisjeve për përfituesit e fazës së dytë të Programit të vetëpunësimit

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) përmes Programit të Tregut Aktiv të Punës (ALMP) 2 ka filluar dorëzimin e mjeteve dhe pajisjeve për përfituesit e fazës së dytë të Programit të vetëpunësimit 2019.

Të mërkurën në një ceremoni rasti, në të cilën të pranishëm ishin Drin Haraçia, drejtor i Agjencisë së Punësimit dhe Valbona Bogujevci, ndihmëse e

përfaqësueses së Përhershme të UNDP-së në Kosovë, u bë dorëzimi i pakos me mjete dhe pajisje të rrobaqepësisë Kimete Limani, e cila si punëkërkuese e regjistruar në zyrën e punësimit në Prishtinë, përmes një procesi konkurrues, ishte një nga përfitueset e grantit në profilin e rrobaqepësisë në kuadër të Programit të Vetëpunësimit i cili është një nga 22 profilet të cilët mbështeten nga ky program.

Programi i Vetëpunësimit është

pjesë e përpjekjeve gjithëpërfshirëse të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Agjencisë së Punësimit në bashkëpunim me ALMP 2 që synon promovimin dhe zhvillimin e sektorit privat për krijimin e vendeve të punës ku vetëm gjatë vitit 2019 janë mbështetur mbi 260 punëkërkuës të papunë në hapjen e bizneseve të reja të themeluara në kuadër të këtij programi.



ASK-ja: Paga mesatare bruto sillet rreth 378 euro

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e anketës strukturore të ndërmarrjeve për vitin referues 2018. Sa i përket treguesit të pagës mesatare mujore bruto, ajo sillet rreth 378 euro në aktivitetet e përfshira në anketë

**EPOKA
ERE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve për vitin referues 2018. Sipas ASK-së, ky publikim, me të dhënat që ofron, synon t'i paraqesë disa nga treguesit ekonomikë sipas strukturës së veprimtarive ekonomike. "Sipas rezultateve të dala nga ky publikim, rezulton se, sipas sektorëve ekonomikë, numri më i madh i ndërmarrjeve i takon: tregtisë me 16 143 ndërmarrje ose, shprehur në përqindje, 45.4 për qind; shërbimeve biznesore dhe shërbimeve të tjera me 5 250 ndërmarrje, ose 14.8 për qind; industrisë përpunuese (prodhim-it) 4 930 ndërmarrje, ose 13.9 për qind; akomodimit dhe aktiviteteve të shërbimeve me ushqim 3 683 ndërmarrje, ose 10.4



për qind; ndërtimtarisë 2 849 ndërmarrje, ose 8.0 për qind; transportit dhe magazinimit 1 351 ndërmarrje, ose 3.8 për qind; informacionit dhe komunikimit 982 ndërmarrje, ose 2.8 për qind; xehetarisë dhe gurëthyesit me 161 ndërmarrje, ose 0.5 për qind; furnizimit me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitetet revitalizimi të tokës me nga 126 ndërmarrje, ose 0.4 për qind; si dhe, furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të

kondicionuar me 65 ndërmarrje, ose 0.2 për qind", thuhet në këtë raport.

Sipas ASK-së, sa i përket punësimit për sektorët ekonomikë, numri total i të punësuarve arrin shifrën 177 852, prej të cilëve sektori i tregtisë përbën rreth 60 349 të punësuar ose, shprehur në përqindje, 33.9 për qind; industria përpunuese (prodhim) 27 125 të punësuar, ose 15.3 për qind; shërbimet biznesore 22 004 të punësuar, ose 12.4 për qind; ndërtim-

taria me 20 533 të punësuar, ose 11.5 për qind; akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim me 13 955 të punësuar, ose 7.8 për qind; informacioni dhe komunikimi 10 603 të punësuar, ose 6.0 për qind; si dhe, sektorët e tjerë kanë më pak se 5 për qind të punësuar. "Karakteristikë tjetër, që vlen të përmendet, është edhe qarkullimi i realizuar nga ndërmarrjet, ku dominon tregtia me një pjesëmarrje prej 54.6 përqindësh, ndërtimtaria me 11.6

për qind, industria përpunuese (prodhim) me 11.5 për qind, furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 6.4 për qind, aktivitetet e shërbimeve të tjera me 5.1 për qind, kurse sektorët e tjerë të veprimtarive ekonomike rezultojnë me një përqindje më të vogël të qarkullimit. Sa i përket treguesit të pagës mesatare mujore bruto, ajo sillet rreth 378 euro në aktivitetet e përfshira në anketë", theksohet në raportin e ASK-së.

Përmbillet me sukses marrëveshja e re për sigurime sociale midis Kosovës dhe Holandës

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Negociatat për marrëveshjen e re për sigurime sociale midis Kosovës dhe Holandës përmbillen me sukses në Hagë. Kështu ka bërë me dije ambasadori i Kosovës në Holandë, Lirim Greiçevci. "Marrëveshja e re e shfuqizon

atë midis ish-Jugosllavisë dhe Holandës dhe e rregullon në mënyrë adekuate çështjen e ofrimit të pensioneve të shtetasve të të dy vendeve. Shpresoj se Kuvendi i Kosovës, pas konstituimit, do ta shqyrtojë dhe ratifikojë këtë marrëveshje me përparësi", ka shkruar ai. Greiçevci

ka përgëzuar delegacionin e Kosovës për qasjen profesionale dhe konstruktive të përbërë nga Bahri Xhaferi, kryesues; Minire Begaj; Lulzim Karaxha nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Albesjana Iberhysaj nga Ministria e Punëve të Jashtme.



Diskutohet qeverisja e kryetarëve të komunave të mëdha në mes të mandatit të tyre

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Demokraci Plus (D+) mbajti tryezë diskutimi me kryetarë, nënkryetarë dhe zyrtarë të komunave të ndryshme në vend ku u prezantua raporti "Progresi në zotimet për qeverisje të mirë - 2 vite pas", për zotimet e nënshkuara në tetor të 2017-s nga kryetarët e komunave më të mëdha në vend gjatë kohës sa ishin kandidatë për këtë pozitë. Kryetarët u zotuan për publikim të vendimeve në ueb, transparencë financiare, konsultime publike në lagje dhe fshatra, transparencë në prokurim publik, publikim të raportit të përmbushjes së premtimeve si dhe adresim të kërkesave të qytetarëve përmes platformave online.

Debora Peci, hulumtuese në D+,

duke prezantuar të gjeturat e këtij raporti, vuri në pah se në vlerësimin e bërë për vitin 2019, vërehet se edhe këtë vit jo të gjitha komunat kanë arritur t'i përmbushin të gjitha zotimet. Për dallim nga viti i kaluar, këtë vit Komuna e Prishtinës ka arritur t'i përmbushë zotimet, e pasuar nga Komuna e Pejës dhe Gjakovës, e cila ka shënuar përparim nga viti i kaluar.

Ndërsa komuna e cila më së paku ka arritur t'i përmbushë zotimet për qeverisje të mirë është Komuna e Ferizajt.

Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, vlerësoi këtë publikim, duke thënë se kjo komunë mundohet vazhdimësi të mbajë transparencë dhe se për këtë kanë bashkëpunim me donatorë dhe OJQ.

Nënkryetari i Komunës së



Prishtinës, Muhedin Nushi, tha se pajtohet me të gjeturat e raportit të D+ dhe se janë të përqendruar nga mandati i parë në transparencë, në digitalizim dhe në konsultat publike. "Në fund të vitit kryetari do ta bëjë publikimin e raportit me 100 premtimet e tij",

tha ai.

Nënkryetarja e Komunës së Prizrenit, Memnuna Ajdini, vuri në pah se kjo komunë ka përmirësime dhe se platformat online kanë ndikuar në bashkëpunim me komunitetet, por e paraqiti si problem pjesë-

marrjen e ulët të grave, sidomos në debate publike.

Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, theksoi se raporte të tilla si të D+ ndihmojnë komunat për përmirësime në performancë dhe çështje të tjera, duke vënë në pah se sa i përket transparencës, janë shpërblyer si komuna më e mirë në vend.

Drejtori për Buxhet dhe Financa në Komunën e Gjilanit, Zijadin Maliqi, tha se nuk pajtohet me njërin nga të gjeturat e raportit të D+ sa i përket transparencës buxhetore, duke thënë se çdo gjë është e publikuar online. Por, ai e pranoi se te fusha e prokurimit nuk qëndrojnë mirë.

Fatos Axhemi nga Komuna e Gjakovës theksoi se janë në përkrahje të platformave online të D+ që kontribuojnë në transparencë dhe jo vetëm.

Prishtina ndez dritat e festave të fundvitit



PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka postuar disa fotografi në profilin e vet në "Facebook" të disa prej sheheve të Prishtinës të rregulluara me drita për festat e fundvi-

tit. Ahmeti ka shkruar se, megjithatë, këtë vit festat nuk janë të njëjta. "Sivjet festat e fundvitit nuk janë të njëjta! Megjithatë, fëmijët meritojnë të gëzohen kudo që janë", ka shkruar Ahmeti.

Filloi hapja dhe zgjerimi i puseve për ujë në Gurbardh të Malishevës

MALISHEVË, 4 DHJETOR (ER) - Në Gurbardh të Komunës së Malishevës, në bashkëpunim në mes të KRU "Hidroregjioni jugor" dhe Komunës së Malishevës, kanë filluar shpimet për hapjen e puseve në ujësjellësin e këtij fshati, prej ku furnizohen katër fshatra me ujë për pije.

Ditët e fundit pusët në këtë ujësjellës kanë shteruar.

Punimet për hapjen e puseve i kanë parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori i urbanizmit, Islam Vrenezi, të cilët janë njoftuar me ecurinë e punimeve. "Pusët kanë

shteruar dhe jemi të detyruar që ta bëjmë hapjen e puseve, edhe për rritjen e kapaciteteve, për këtë ujësjellës", ka thënë Berisha. Ditë më parë Kompania Regionale e Ujërave "Hidroregjioni Jugor" kishte njoftuar se kanë shteruar pusët si pasojë e tërmetit të 26 nëntorit.



Aktakuzë për posedim dhe shitje të narkotikëve

PRISHTINË, 4 DHJETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër F. M. dhe E. H. për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale "blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge" nga neni 267, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 dhe veprën penale "posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge" nga



neni 267, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të


Republikës së Kosovës (KPRK). Sipas aktakuzës, i pandehuri F.

M. pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes ose ofrimit për shitje substancë apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substancë psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që më 23. 08. 2019, me dijen e të akuzuarit E. H., derisa në orët e vona të mbrëmjes lëviznin me automjetin e të akuzuarit E. H., në një çantë krahu kanë pasur pesë qese plastike me substancë narkotike të llojit "kokainë", në peshë prej 3.88 gramësh, një qese plastike me substancë

narkotike të llojit "ekstazi", në peshë prej 0.32 gramësh, 18 qese plastike me substancë narkotike të llojit "kokainë" në peshë prej 15.77 gramësh dhe një peshore me mbishkrimin "constante", që shërben për matjen e narkotikut, ku edhe është kapur nga policia në rrugën "Beteja e Vrrinit" në Prizren.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat u vihen në barrë.

Tërmeti, shteti dhe njerëzit



Nga Bedri ISLAMI

Në çastin kur pashë kamionët e mëdhenj, një vari pafund që sapo kishin ardhur nga Kosova dhe po parkonin në hapësirën e gjerë të fondacionit "Fundjava ndryshe", në dalje të Tiranës, ku fillon rruga e ëndërruar e Arbërit dhe ku, për një rastësi, drejtuesi i fondacionit quhet Arbër Hajdari, kisha nga ato emocionet që të drithërojnë.

Makina të mëdha, në shumë nga të cilat ishte vendosur flamuri kombëtar, ecnin ngadalë dhe po vendoseshin në radhë për të nisur shkarkimi i tyre.

Disa javë më parë rastësisht kisha qenë në qendrën e këtij fondacioni, dikur një mbeturinë reparati ushtarak, ku ende dukeshin disa godina të mbetura, si gërmadha të një kohe të shkuar dhe, bri tyre, ata që ishin restauruar dhe dukeshin si ndërtesa moderne komode, gjithë dritë, mes një gjelbërimit të habitshëm.

Më kishte bërë përshtypje gjallëria që vlonte aty, të rinj, shumë të rinj dhe të reja, të cilët lëviznin vrullshëm dhe ndiheshin të shqetësuar. Pata biseduar me shumë prej tyre, të shumtët vullnetarë, studentë, gjimnazistë, punëtorë dhe gjithçka, ende pa u ndjerë shenjat e tërmetit, më habiste me entuziazmin, besimin që shfaqnin, ëndrrat që kishin.

Ata ishin vërtet "Fundjava ndryshe", por në të vërtetë donin një Shqipëri ndryshe.

Kur prisnim ardhjen e makinave të mëdha nga Kosova kisha kohën e duhur për t'i parë

ndryshimet dhe punët që kishin nisur. Të habitshme.

E kisha pritur, ashtu si gjithë të tjerët, që shqiptarët e Kosovës dhe në trevat e tyre në Maqedoninë Veriore, do të vepronin kështu. E kam pritur se do të ngriheshin menjëherë, pa asnjë dekret, asnjë vendim qeveritar, asnjë urdhër. Natyrshëm dhe pa bujë. 12 mauna po parkonin njëra pas tjetrës. Secila nga 20 tonë ushqime. Rrugës ishin edhe 9 të tjera nga Tetova, Gostivari dhe Struga. Telefonat binin vazhdimisht. Pa ndërprerje. Lajmet vinin si zogjtë. Njëri pas tjetrit koordinatorët lajmëronin për makinat që do të niseshin, ndihmat që po grumbulloheshin. Magazina e madhe e "Fundjavës ndryshe", si dukej, do të ishte e vogël, megjithëse jashtëzakonisht e madhe.

Deri pas mesnate sheshi ishte një fushë beteje për të mirën, për ta nisur përballimin e asaj që sapo kishte ndodhur dhe që ende nuk dihej se kur do të mund të ndalonte.

Dhjetëra të rinj e të reja, përmes natës, tentonin të sillnin një pjesë të shpresës.

Rrallëherë kisha parë një ecuri të tillë dhe ajo që shihja, ashtu si po ndodhte, më kishte emocionuar si rrallëherë.

Të nesërmen, së bashku me një grup miqsh do të udhëtoja drejt Kosovës për të qenë pjesë e përrurimit të tri përmendoreve të mëdha të heronjve të luftës në Kosovë, Shaban Jasharit, Hamzë Jasharit dhe Adem Jasharit.

Gjithë rrugës shihnim vargje makinash të pafund nisur drejt Shqipërisë. Në telefonin tim kishin ardhur thirrjet e miqve të vjetër nga Kosova, të cilët ftonin cilëndo familje shqiptare të strehohej në banesat e tyre. Gazetari Adnan Asllani, ish-kryeredaktori i "Zërit të Kosovës", Muhamet

Mavraj, drejtuesi i "Epokës së re", Luan A. Xhemaili, shumë të tjerë. Luani, me babanë e të cilit jemi miq të vjetër, më shkruante se do të nisej për në Prishtinë dhe, jo vetëm do ta strehonte familjen që do të ishte atje, por do ta bënte furnizimin e tyre ushqimor për gjithë kohën që do të rrinin.

Në Drenas, pjesa e parë e Drenicës, së bashku me akademik Moikom Zeqon, na ftuan ta bëjmë zbulimin e tri përmendoreve, së bashku me personalitete të Kosovës, por ajo që më kishte bërë të ndjeja veçanti dhe mrekulli të solidaritetit, e bënte gjithçka më të afërt.

Kishte nisur nga lëkundjet e tokës, përmbytyet, për të shkuar drejt një fondacioni - mrekullie rinore dhe për të arritur te ky varg i pafund makinash dhe hapje dymsh si hapje zemrash. 25-vjeçari Arbër Hajdari, gjatë gjithë asaj nate, duke qëndruar në shirat që binin dhe shpresën se gjërat do të zgjidheshin.

Pastaj mendova: po shteti ku

ishte në çastet e para?

Kishte rënë shteti apo kishte qenë i përgjumur?

Si është e mundur, i thashë vetes, që kaq befaz, apo jo kaq befaz, shteti do të ishte i përgjumur, për të pasur një zgjim tjetër lloj?

A kishte pasur në Shqipëri një drejtori të emergjencave që po bënte të vetmen punë në çastet e para, përmes një thirrje "sillni ndihmat te ne", si shenjë që njerëzit po kishin më shumë besim te fondacionet si ky sesa te vetë shteti?

Më shfaqej shpeshherë pamja e drejtorit të emergjencave, atë çast që e pashë, më saktë, kapërdisur me një veshje të shtrenjtë, kur punonjësit e tij nuk kishin as doreza për t'i kapur gurët.

Çfarë kishte ndodhur me shtetin që dhuronte koncesione qindra milionë euro dhe nuk kishte në depot e tij as gjërat më të zakonshme, më të thjeshtat, që duheshin domosdo, të paktën pas sinjaleve të 21 shtatorit të këtij viti?

Nuk ishte zgjuar ende shteti nga

ajo që kishte ndodhur dy muaj më parë? Një emergjencë civile e rënë do të thotë një ndihmë e parë e shuar.

Atë që shteti nuk e bëri në çastet e para, e bënte njerëzit.

Tani radha është e shtetit.

Komiteti Kombëtar i Rindërtimit është vetëm një strukturë.

Nëse aty qeveria do të vendosë të drejtojë njerëz të korrumpuar, figura që prej kohësh duheshin larguar nga politika e që vendin do ta kishin tjetërkund, shumë gjëra do të jenë të dështuara. Besimi i njerëzve do të jetë i dështuar. Në krahët e shefit të qeverisë pashë figura idealistësh dhe përfituesish.

Cilët do të zgjedhë Edi Rama?

Idealistët apo përfituesit?

Ata të cilët shquhen për ndershmëri dhe përkushtim apo të tjerët, emri i të cilëve është prej kohësh jashtë besimit njerëzor? Sprova e qeverisë ka ardhur!

Ajo, ose do t'i rivendosë lidhjet me njerëzit që e besuan dhe duan ta besojnë, ose do të humbasë gjithçka.



Faleminderit bijtë e Dardanisë!



Elis KUÇI

Shqipëria u plagos rëndë nga tërmeti i pamëshirshëm që nuk kurseu jetët e pafajshme të shumë qytetarëve. Situata katastrofike po venit shpresën se gjendja pas tërmetit do të kthehet shpejt si më parë, duke i shtuar më shumë rrudhat në fytyrën e munduar të shqiptarëve të ndershëm. Por, si çdo plagë që ka nevojë për mjekim që t'i rigjenerojë qelizat e humbura, edhe nëna Shqipëri, ashtu e rrëzuar për tokë, pa t'i vijnë në ndihmë

bijtë e Dardanisë, bijtë e trungut të saj. Ashtu si djali që lehtëson dhimbjen e nanës, vetëm me zërin e tij, ashtu edhe bijtë e Dardanisë ngjallën shpresën te shqiptarët e Shqipërisë, të gjunjëzuar përballë inatit të natyrës. Bijtë dardanë ishin aty, duke sfiduar barbarinë që la pas katastrofa natyrore, jo vetëm për t'i "mjekuar" plagët fizike, por për t'i lehtësuar shpirtërisht vëllezërit e tyre që lëngonin nën rrënoja. Me ardhjen që në orët e para të tragjedisë, duke parë edhe shokun që prodhoi pas-tërmeti, misionet nga shteti i Kosovës morën komandën e kërkim-shpëtimit në qytetin e shkatërruar të Durrësit, duke u bërë një trup, aq sa ishte e vështirë të dalloje se kush përfaqësonte shtetin e Kosovës e kush përfaqësonte shtetin e Shqipërisë.

Kundër tezës që Kosova na ktheu borxhin

Veç raportimeve për ngjarjen, u bë lajm që një autokolonë e ushtrisë, policisë dhe agjencive të tjera nga Republika e Kosovës po vjen drejt Republikës së Shqipërisë për të përballuar emergjencën e shkaktuar nga tërmeti. Për mua kjo situatë nuk përbën lajm. Do ishte lajm sikur vëllezërit tanë mos të vinin për të na dhënë një dorë dhe për të na lehtësuar dhimbjen, pas këtij mortit që na ra. Bijtë Dardan nuk erdhën si shigjetë për të ndihmuar nënën Shqipëri, sepse u kujtuan se kush i priti në vitin 1999, erdhën (për këtë jam i bindur) se i thërriti gjaku. Vëllai asnjëherë nuk e ndihmon vëllanë për t'i larë borxhin, por e ndihmon se e ndjen dhimbjen po njëllon, e ndihmon se kanë të njëjtën rrënjë, e ndihmon se kanë

pirë të njëjtën sisë atë të Nënës Shqipëri. Por pse me kaq vonesë falënderimi për vëllanë e dalë në shtëpi me vete, që luftoi pa u menduar dy herë për të pastruar plagët e lëna nga tërmeti? Sigurisht pak me vonesë, pasi në traditën e lashtë shqiptare si fillim respektohet miku, (grupet e shpëtimit nga vende të ndryshme) e më pas vëllai i cili në thelb ka dhimbje po njëllon për fatkeqësinë që padrejtësisht shkaktoi tërmeti.

Shteti i Kosovës, shembull për menaxhimin e fatkeqësive natyrore

Megjithëse afro 12 vjeç, shteti i Kosovës tregoi se i ka kapacitetet për të përballuar më së miri fatkeqësinë natyrore. Nuk e di sa është buxheti i qeverisë për institucionet që merren me menaxhimin e

krizave nga fatkeqësitë natyrore, por investimi në këtë fushë nuk është asnjëherë para e harxhuar kot. Kjo për faktin e thjeshtë se Kosova ka dhënë mjaftueshëm jetë të pafajshme, nga padrejtësitë që i bëri shekulli i kaluar, prandaj lipset ngritja e çdo kapaciteti për të përballuar situatat e padëshirueshme. Së fundmi, por jo për nga rëndësia, bashkimi i forcave të kërkim-shpëtimit në një institucion të vetëm, që përgjigjet pas çdo fatkeqësie natyrore në çdo centimetër të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Le të jetë bashkimi në një trup të vetme të institucioneve të emergjencës prelud i bashkimit në një trup kombëtar të shumë shërbimeve të tjera. Ky bashkim veç shpirtëror, do prodhonte rezultate pozitive në shërbim të qytetarëve të të dy vendeve.

E rrallë

Gjendet këlyshi 18,000-vjeçar

Shkencëtarët po përpiqen të përcaktojnë nëse një këlysh i ngrirë 18-mijëvjeçar, i cili u gjet në Siberi është qen apo ujë. Këlyshi ishte vetëm dy muajsh kur ndaloi së jetuari, por falë kushteve të akullta në Siberi, trupi i tij u ruajt në mënyrë të përsosur, përfshirë leshrat, surratin dhe dhëmbët. Testet e ADN-së e kanë bërë të pamundur të përcaktohet se çfarë lloj kafshe është, dhe shkencëtarët spekulojnë se këlyshi mund të përfaqësojë një lidhje evolucionare midis ujqërve dhe qenve të sotëm. Analizat e



gjeneve kanë treguar se bëhet fjalë për një këlysh të gjinisë mashkullore. Studiuesi Dave Stanton i Qendrës për Paleontologji në Suedi tha për CNN se kafsha mund të ishte paraardhësi i qenve dhe ujqërve.

FOTO E DITES



Një i ri në një plazh në Chennai të Indisë shihet i mbuluar nga uji shkumues. /AFP/

E jashtëzakonshme Krevati që ju shpëton nga tërmeti

Website-i teknologjik "Futurism" ka zbuluar pak kohë më parë një koncept kundër tërmeteve, dhe vjen në formën e një krevati. Sipas portalit të njohur, shtrati mund t'ju shpëtojë jetën në rastet e tundjes së tokës kur sensorët e krevatit do të ndjejnë lëkundje, dysheku futet në një "sënduk" të sigurt. Mekanizmi është i projektuar në qendër të krevatit pa na dëmtuar gjatë rënies. Ndërkohë,



kapakët e "sëndukut" prej çeliku janë krijuar në mënyrë të tillë që të na mbajnë të sigurt derisa të mbarojë tërmeti. Krevati, do të ketë gjithashtu vend për mjetet e nevojshme, ujë dhe ushqim. Koncepti është projektim i kinezit Wang Wenxi.

BARSOLETA E DITËS



Një burrë dhe grua shkojnë në operë. Pas një gjysmë ore që kishte filluar shfaqja, gruaja i thotë burrit: - Shiko atë burrin në krahun tënd si e paska zënë gjumi. Burri: - Për të më treguar budallallëqe më zgjon nga gjumi?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Dikush nga një kulturë tjetër po e tërheq kuriozitetin tuaj tani dhe ju keni mjaftueshëm kohën që të eksploroni pak botën e tyre sot. Shijoni ushqimin e kulturës së tyre, dëgjoni muzikën dhe vizitoni disa faqe në internet për të mësuar pak më shumë rreth historisë së kësaj kulture.</p>	 <p>DEMI Dikush që keni menduar se e njihni mirë do të veprojë në një mënyrë të pazakontë ose konfuzë. Për ta bërë situatën më komike ju do përpiqeni ta imitoni atë dhe ky është një frymëzim i mirë për të. Përzieni konfuzimin e mikut tuaj me argëtimin dhe çdo gjë do bëhet më e lehtë.</p>	 <p>BINJAKËT Puna më me shumë se një person mund të krijojë ndjenja të tensionuara ose të zemëruara sot. Kështu që nëse po punoni në grup, përpiqini ta ndani ngarkesën e punës në mënyrë të barabartë tek të gjithë. Nëse punoni me një grup të madh njerëzish është pak e vështirë për të arritur rezultatet që mund të dëshirosh.</p>	 <p>GAFORRJA Ju çdo ditë përpjekur të bëni çdo gjë për njerëzit e tjerë, por pse të mos bëni diçka për veten tuaj sot? Gjetja e një oreri në dy për të shpenzuar vetëm në një qoshe të qetë mund të jetë gjithçka që duhet për ta rikthyer veten në qendër të përparësive të jetës suaj, aty ku ju takon.</p>	 <p>LUANI Sot nuk do keni energji të mjaftueshme prandaj pini shumë lëngje që të mbani veten në këmbë dhe të përballoni sfidat e ditës. Ngjitja edhe në malin më të lartë thjesht kërkon që ju të vendosni njërin këmbë para tjetrit shumë më shpesh sesa zakonisht.</p>	 <p>VI RGJËR ESHA Është joshëse të kontrollosh vetëm një dramë që filon të shpalojë midis miqve ose anëtarëve të familjes, por duhet të sigurohesh që atë që thua është përgjigja e duhur. Ju mund të ndihmoni dikë më shumë sesa e mendoni. Ndikimi juaj mund të ndihmojë në krijimin e një rezultati paqësor nëse flisni me mirësi dhe butësi.</p>
 <p>PESHORJA Disa lajme shumë të mira do vijnë për ju sot dhe do ta kaloni pjesën tjetër të ditës duke i ndarë ato me njerëzit përreth. Sa herë që e bëni, niveli juaj i energjisë do të rritet më i lartë dhe do ndiheni shumë të lumtur.</p>	 <p>AKREPI Ekzistojnë disa sfida të mëdha që vijnë për ju në të ardhmen, por dita e sotme është e mbushur plot me gjëra të vogla, argëtuese dhe të lehta! Ju mund të merrni kohë shtesë nga puna ose shkolla sot. Pak shkëputje nga rutina juaj e përditshme nuk do t'i bëjë askujt ndonjë dëm.</p>	 <p>SHIGJETARI Vishni veshjen tuaj më të mirë profesionale dhe fytyrën tuaj më të mirë të lojës sot, sepse shanset janë që ju do të vendoseni para publikut. Ka pasur një ndryshim të papritur në formacionin e një takimi ose ngjarjeje dhe roli juaj do të përmirësohet mjaft.</p>	 <p>BRICJAPI Një çështje e rëndë në jetën tuaj nuk do të marrë zgjidhje shumë shpejt por do gjeni një lehtësim të madh nga miqësia që do ju ofrojë një mik i ri. Pranoni çdo ftesë që ju ofrojnë, dhe lini veten të përqendrohni në diçka tjetër përveç afateve, buxheteve ose shifrave të vështira.</p>	 <p>UJORI Një anëtar i ri i familjes ose grupit tuaj shoqëror ka shumë për t'ju mësuar. Ata kanë kaluar atë që po kaloni dhe kanë disa këshilla interesante për ju.</p>	 <p>PESHQIT Kjo do të jetë një ditë befasuese, do të fillojë e qetë dhe e lehtë, por mos e lini veten të ndihet shumë rehat! Ndërsa dita ec përpara, do të ketë shumë zhurmë që vijnë nga njerëz që janë relativisht të rinj në skenë.</p>

"NI ZO I LIRË"!



Agim VINCA

Kështu shkruan në hyrje të sallës në të cilën më 28 nëntor të këtij viti u hap ekspozita me sendet personale të veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare shqiptare, Adem Demaçit.

Është mirë që edhe në këto ditë zie për shqiptarët, kujtohet e nderohet Njeriu që tërë jetën ia fali Kombit të vet, qoftë edhe me një ekspozitë modeste.

Nuk po flas për ekspozitën në përgjithësi, e cila lë për të dëshiruar, por për titullin e saj, që është jo vetëm i paqëlluar, por edhe paradoksal.

"NI ZO I LIRË"!

Ky titull, që është një përzjerje e zhargonit popullor me gjuhën e adoleshentëve tanë, e paraqet Adem Demaçin jo si një figurë të madhe unifikuese të Kombit, por si një patriot lokal.

Adem Demaçi nuk bëri 28 vjet burg për të qenë "ni zo" e as "nji za", por ZËRI i vërtetë, I LIRË, përbashkues e vizionar i të gjithë shqiptarëve, kudo që janë.

Ai ishte Zëri që guxoi të thoshte gjashtëdhjetë e sa vjet më parë se "nëse Serbia e Jugosllavia nuk heqin dorë nga okupimi i Kosovës, atëherë nuk do të ketë paqe në Ballkan, në Jugosllavi e as në Serbi".

Vetëdija e tij ishte vetëdije mbarëkombëtare, e jo shprehje e ndarjeve politike të tokës së copëtuar shqiptare.

Adem Demaçi ishte mbështetës i madh i gjuhës së përbashkët letrare shqipe, të cilën e fliste dhe e shkruante për mrekulli.

Ndër punët e para që bëri pas daljes nga burgu në vitin 1990, ishte kthimi në gjuhën standarde i kryeveprës së tij, romanit "Gjarpit e gjakut", i cili në botimin e rishikuar tridhjetë e sa vjet pas botimit të parë (1958), do të mbajë titullin: "Gjarpinjtë e gjakut".

Në shënimin e vënë në fund të veprës, autori thekson se ky është "versioni autentik i tekstit të romanit".

Të gjitha veprat që shkroi e botoi më vonë: nga "Libër për Vetmohimin" (1994) deri te "Alb Prometeu" (2012), i shkroi në gjuhën e njësuar shqipe, duke ruajtur aty-këtu vetëm ndonjë trajtë dialektore për ngjyrim ambiental.

Njeriu që në vitin 1963 themeloi organizatën politike me emrin Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve

(LRBSH), kurse në gjyq mbrojti fuqishëm idenë e bashkimit të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi me shtetin amë, Shqipërinë, nuk mund të shenjohej në vitin 2019 me sloganin arkaik, që i vjen era myk: "Ni zo i lirë"!

Adem Demaçi nuk është: "Ni zo i lirë", por NJË ZËRI I LIRË!, më i liri, më i artikuluar dhe më vizionari ndër shqiptarë për gati një shekull të tërë.

Ç'është ky "zo", që krejt ndryshe nga Adem Demaçi dhe dishepujt e tij, i kthen prapa shqiptarët, "në kohën e baba Qemos" dhe e cenon tiparin themelor të identitetit të tyre, gjuhën shqipe?

Nuk besoj se është bërë në shenjë solidarizimi me të ashtuquajturin "identiteti i ri", siç do të dëshironin disa individë dhe grupe të caktuara, por besoj nga nguti dhe pakujdesia.

Jam i bindur se po të ishte gjallë Baca Adem, me gjithë zemërgjerësinë që e karakterizonte, nuk do të pajtohej që ekspozita e tij të pagëzohej ndryshe, pos në gjuhën letrare kombëtare.

Nga ekspozita shihet se "Baca" edhe letrat familjare i shkruante në gjuhën letrare. "E dashur motër" - shkruan ai në letrat dërguar të motrës nga burgu, ndërsa në ballë të ekspozitës qëndron trajta e shtirë: "NI ZO I LIRË"!

Ditën që me një mikun tim, ish-i burgosur politik dhe bashkëveprimtar i Bacës Adem, e

vizitova ekspozitën në fjalë, kishin ardhur në vizitë një grup nxënësish nga Ferizaj me arsimtarin e tyre kujdestar. Mund ta merrni me mend se ç'efekt bën në sytë e shkollarëve dhe ç'konfuzion krijon në mendjet e tyre pëlhura me shkronjat: "NI ZO I LIRË"!

Përse kjo gjuhë portalesh në një institucion serioz si Muzeu Historik i Kosovës dhe, për më keq, nën firmën e "bacës Adem"? Adem Demaçi nuk është figurë lokale, por personalitet i përmasave të mëdha, kombëtare e ndërkombëtare, prandaj ai nuk mund të nderohet me gjuhë të stërkequr, që nuk është, madje, as gegërishtja letrare e kohës kur doli në skenë ai.

Ekspozitën e Adem Demaçit në Muzeun e Kosovës e kanë përgatitur familjarët e tij. Mirëpo Adem Demaçi, sikurse edhe personalitetet e tjera të mëdha të historisë dhe kulturës kombëtare, nuk i takon vetëm familjes së vet, por mbarë kombit shqiptar. Prandaj, për trashëgiminë e Adem Demaçit duhet të kujdeset një ekip a institucion i përbërë nga njerëz kompetentë, që e njohin mirë jetën dhe veprimtarinë e tij, në radhët e të cilëve duhet të ketë bashkëluftëtarë dhe bashkëvuajtës të tij (nga ata që janë gjallë), por edhe historianë, politikologë, sociologë, filozofë, juristë e të tjerë, pa harruar kurrësi as studiuesit e gjuhës dhe të letërsisë shqipe.



SABILEKEÇMEZI-BASHA

DHEMBJE PËR ITAKËN

Për Itakën

*Nuk ka nevojë
Ama asnjëherë
Të vdesësh për mua
Biri im*

*Nuk ka nevojë
Të vdiqët, ama
As për veten tënde*

*Për Itakën
Hëm...
Itakën
E vlen të vdiqët
E vlen të jetohet*

Itakë pse dhemb...

*Vetëm edhe një herë do të pyesja
Itakë pse dhemb
Nata skëterrë
Dëshirat i salvuam Itakë
Buzëqeshjet në fytyra i bëmë tatuazh
Duart në fshesa thithëse i shndërruam
Nga netët e mbarsura*

*Itakë, në shurdhë-memecë ishim shndërruar
Gjakimet na digjin si plaga
Dhe s'mundeshim as me bëza*

*Itakë, athua përsëri do të përcëllon dielli
Që të zvarritemi kah ujëvara
kah vjeshta e fundit
Për të pasur dhembje, dhembjet e oktapodit
Se si lozin me nusërinë tonë*

*Do të njohë Itakë
Të harxhuar nga stina
Unë do të vij
Për të mos ikur...
Kurrë... më...
Nga lëkura jote*

Kushtrim

*Përsëri bie kushtrimi
Në Itakën e lodhur*

*Konstantini e shalon kalin
Doruntina në pritje i ha thonjtë
Rrugët në arenë shndërrohen
Itaka dënes në pritjen e saj*

*Përsëri bie kushtrimi...
Itakë*



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Ferizaj beson në mbijetesë

Futbollisti Dardan Çerkini për "Epokën e re" ka thënë se Ferizaj ka shanse shumë të mira ta sigurojë mbijetesën. "Fitorja në Skenderaj ishte shumë e rëndësishme për ne dhe ishte fitorja që na jep shumë besim se do të mbijetojmë në Superligë. Normalisht se në pranverë na pret shumë punë, por të bashkuar dhe me angazhim maksimal në stërvitje dhe ndeshje do t'ia arrijmë synimit", ka thënë Çerkini



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 4 DHJETOR - KF Ferizaj po beson maksimalisht se do të arrijë të mbijetojë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll ashtu sikurse bëri edhe edicionin e kaluar duke tejkaluar të gjitha parashikimet për të mbetur në mesin e skuadrave më të mira në vend. Sivjet gara për mbijetesë është edhe më e "egër" sepse katër skuadra bien në Ligën e Parë.

Futbollisti Dardan Çerkini ka thënë se fitorja në ndeshjen e fundit në sezonin vjeshtor ndaj Drenicës në Skenderaj (0-2) i ka dhënë besim të madh skuadrës që drejtohet nga Bekim Isufi, Ferizajt, që në pranverë të luftojë me të gjitha forcat për të mbetur në topdhjetëshen e elitës. "Fitorja në Skenderaj ishte shumë e rëndësishme për ne dhe ishte fitorja që na jep shumë besim se do të mbijetojmë në Superligë. Normalisht se në pranverë na pret shumë punë, por të bashkuar dhe me angazhim maksimal në stërvitje dhe ndeshje do t'ia arrijmë synimit", ka thënë Çerkini për "Epokën e re".

Pavarësisht se shënoi dy gola në stadiu-

min "Bajram Aliu" me vlerë të tri pikëve, Çerkini nuk e konsideron veten "hero" të Ferizajt, por ka thënë se të tillë janë që nga drejtori, trajnerët dhe gjithë lojtarët. "Mendoj se nga drejtori, trajnerët dhe të gjithë lojtarët janë 'heronj' të Ferizajt, sepse kishin shumë probleme në këtë stinor, por kishin të gjithë durimin për

REZULTATET NË SEZONIN VJESHTOR

Drita-Ferizaj	0-1
Ferizaj-Gjilani	0-3
Flamurtari-Ferizaj	1-0
Ferizaj-Vushtrria	0-1
Dukagjini-Ferizaj	0-1
Ferizaj-Drenica	0-1
Feronikeli-Ferizaj	5-0
Llapi-Ferizaj	2-4
Ferizaj-Prishtina	0-2
Trepça '89-Ferizaj	1-0
Ferizaj-Drita	0-2
Ferizaj-Flamurtari	1-0
Vushtrria-Ferizaj	3-1
Ferizaj-Dukagjini	2-0
Drenica-Ferizaj	0-2

këta muaj dhe normalisht se të gjithëve na takon ky epitete. Ferizaj do të jetë skuadër më serioze në sezonin pranveror, por edhe rezultatet do të jenë më të mira", ka shtuar ai.

Të martën është hedhur shorti për Digitalb Kupën e Kosovës, kurse në këtë rreth skuadra e Ferizajt do të përballlet me Lirinë në Prizren. Futbollisti Çerkini ka shprehur optimizëm se skuadra e tij me sukses të plotë do ta kalojë edhe këtë sfidë. "Me ndeshjen ndaj Lirisë në kuadër të Kupës përfundon sezoni vjeshtor, prandaj ne shkojmë atje të luftojmë me të gjitha forcat dhe besoj do të shohim çfarë do të nxjerrim. Kam besim në skuadrën se do të bëjë një mbyllje të mirë të këtij sezoni dhe në pushim të shkojë më e relaksuar", ka deklaruar Çerkini.

Klubi i Ferizajt në Superligë e mbylli në vendin e dhjetë me 18 pikë, pesë pikë është diferenca me zonën që mbijeton në këtë rang garash. Një fakt interesant është se skuadra e Ferizajt në shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara nuk ka regjistruar asnjë barazim, por ka regjistruar gjashtë fitore dhe njëmbëdhjetë humbje.

SHKURT

Qorri nënshkruan kontratë me ekipin e parë

Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Feronikeli, e ka prezantuar edhe transferimin e tretë brenda 24 orëve. Në fakt, futbollisti Ardi Qorri nga Akademia e "Niklit" nënshkruan kontratë me ekipin e parë. "Futbollisti nga Akademia e FC Feronikelit, Ardi Qorri, do të nënshkruajë kontratë me ekipin e parë që nga janari 2020. Qorri ka kohë që po stërvitet me ekipin e parë dhe puna e tij e mirë në fushë u vërejt nga shtabi teknik i cili ka vendosur ta shpërblejë me kontratë që e mban me ekipin e parë", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

Klubi nga Drenasi synon nxjerrjen e futbollistëve të talentuar nga akademia dhe politikë e klubit është avancimi i futbollistëve nga juniorët te ekipi i parë.

Tare përgatit planin për transferimin e Muriqit

Drejtori i Lazios, Igli Tare, po mendon seriozisht që të transferojë në kryeqytetin italian sulmuesin shqiptar Vedat Muriqi. Për t'ia arritur këtij qëllimi do ta përdorë edhe futbollistin tjetër shqiptar, Riza Durmishi, i cili së bashku me një shumë parash mund t'ia ndryshojë mendjen ekipit turk të Fenerbahçes. Një plan i tillë u shkon për shtati italianëve, pasi në këtë mënyrë do të përfitonin një nga sulmuesit më të mirë në Turqi, ndërsa do ta largonin nga radhët e veta një lojtar që minutat me skuadrën e Lazios i kanë munguar së tepërmi.

16 skuadra marrin pjesë në turneun 'Fadil Vokrri'

Turneu, organizuar për nder të legjendës së futbollit mbarëshqiptar, Fadil Vokrri, këtë vit do të grumbullojë 16 skuadra. Sipas njoftimit të organizatorëve të turneut memorial, thuhet se 16 shkolla të futbollit do të garojnë njëra me tjetrën për titullin e kampionit. Skuadrat pjesëmarrëse do të janë Prishtina, Trepça, Flamurtari, 2 Korriku, Llapi, Drenica, Ramiz Sadiku, Kosova (P), Kurda, Arsenali, Rilindja, QS Prishtina, Talenti, Viganj, Besëlidhja dhe Ardhmëria. Turneu "Fadil Vokrri" do të nisë më 13 dhjetor, kurse do të mbahet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

Kuka: Nakamura do të aplikojë për nënshtetësi të Kosovës

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Sukseset e mëdha të xhudos, në krye me trajnerin Driton Kuka, kanë bërë që vëmendja e të gjithëve të jetë nga ekipi i xhudos së Kosovës. Madje një xhudist japonez ka shfaqur interesim që t'i bashkohet Kosovës, për çka javën tjetër do të aplikojë për pasaportë të Kosovës.

"Ekipit iu ka bashkëngjitur japonezi Nakamura që javën tjetër do të aplikojë për shtetësinë e Kosovës dhe do të jetë gati për ciklin 2020-2024", ka thënë Kuka. "Fundi i vitit po afron. Si kurrë më parë xhudo ka arritur 6 medalje elitare në vitin 2019. Tri medalje në Minsk në Evropian e tri medalje në

Kampionatin Botëror në Tokio. Në foto po mungon Loriana që sivjet ishte befasia më e madhe", ka shtuar Kuka. Gara e fundit sivjet për xhudistët e Kosovës do të jetë Qingdao në Kinë, e cila ka peshë për pikët drejt Olimpiadës në Tokio e që është caku kryesor.



Mabetex Prishtina sot e zhvillon ndeshjen e fundit në FIBA EuroCupWomen

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kampionia e Kosovës në basketboll për femra, Mabetex Prishtina, sot (e enjte) do ta zhvillojë ndeshjen e fundit në grupe të FIBA EuroCupWomen. Basketbollistet prishtinase janë

mysafire të Beshiktashit në përballjen që zhvillohet në Turqi nga ora 17:00. Skuadra turke ka dy fitore dhe tri humbje, kurse prishtinaset pesë humbje nga po aq ndeshje, por kujtojmë se kjo është hera e parë që një

skuadër nga Kosova është pjesëmarrëse në një garë të nivelit të tillë. Skuadra prishtinase do të mundohet në ndeshjen e fundit në grup të ketë një paraqitje të mirë. Synimi i Mabetex Prishtinës që nga filli-

mi ka qenë që të fitojë përvojë ndërkombëtare në një garë shumë të fortë evropiane, derisa ndodhet në një grup të vështirë me Beshiktashin dhe dy skuadrat ruse MBA Moscow dhe Sparta & k M. R. Vidnoje.



Zhegrova tregon se si prindërit e tij ikën nga Kosova në kohën e luftës

BASEL, 4 DHJETOR - Java filloi me një zhgënjim për Edon Zhegrovën. Në vend se të fluturonte me FC Basel në ndeshjen e Ligës së Evropës në Krasnodar, atij iu desh të qëndrojë në qytetin zviceran për shkak se rusët nuk e njohin Kosovën dhe 20-vjeçari do të duhej të udhëtonte në Beograd për të aplikuar për vizë, shkruan "Blick". "Unë nuk e dëshiroja këtë. Ju e dini situatën", ka thënë fillimisht Zhegrova. Ai nuk e harron luftën dhe tregon se si prindërit e tij ikën nga atdheu i tyre para se të lindte ai. Edoni ka lindur në vitin 1999 në Herford të Gjermanisë, dy vjet më vonë, kur lufta kishte mbaruar, familja e tij kthehet në Prishtinë. Deri në moshën 12-vjeçare ai ishte një talent i rrugës, që bënte çfarë të donte me topin. U provua te Milani, pastaj një jetë me krahime me Lionel Messin. "Askush nuk më thoshte çfarë të bëja, kështu që të mund të dribloja ashtu si dëshiroja, plotësisht i lirë", ka treguar ai. Problemin ia tregoi trajneri Bernard Challandes. "Në futbollin modern lojtarët sulmues gjithashtu kanë nevojë për detyra mbrojtëse. Dyshja e Liverpoolit, Salah dhe Mane, janë duke punuar edhe në mbrojtje". Kundër Young



Boys, Zhegrova i linte lojtarët kundërshtarë prapa me sllallom, duke ndikuar që të fitohet ndeshja me një gol dhe një asistim. Që nga shkurti 2019 Zhegrova është në Basel, por në gjysmën e dytë të atij sezoni, por edhe në këtë aktual,

kryesisht ishte në bankinë. "Nuk ishte e lehtë për të në fillim, por ai ka treguar durim dhe tani po shpërblehet", ka thënë Challandes. Zhegrova është integruar më mirë në ekip dhe tani po i merr vendimet e duhura në fushë.

Lakersat tregojnë forcën ndaj Denverit, San Antonio përmbysi Houstonin

SAN ANTONIO, 4 DHJETOR - Skuadra e San Antonios e ka mposhtur Houstonin me rezultat 135-133, në një ndeshje të jashtëzakonshme, e cila është vendosur në kohën shtesë. Edhe pse Houstoni u shkëput deri në 22 pikë në fundin e periodes së tretë, kjo nuk mjaftoi për ta fituar ndeshjen. James Hardeni realizoi 50 pikë, ndërsa Westbrook një "triple double" (19 pikë, 10 rebounde e 10 asistime), por s'mjaftuan. Për Spursin 55 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit, vendimtarë në këtë sfidë, ku më i miri ishte Walkeri me 28 pikë (Fordes 25 dhe DeRozan 23). Vazhdon të shkëlqejë Dallasi, që



me Donqiq (33 pikë e 18 rebounde) mundi New Orleansin (118-97). Fiton edhe skuadra e lakersave, që mundi 105-96 Denverin jashtë fushës, një përballje mes dy ekipeve pretendente në Perëndim. Lakersat patën gjatë gjithë kohës një epërsi të lehtë, ku u dalluan Davisi dhe Jamesi, me nga 25 pikë secili, raporton "Telesport". Skuadra tjetër e Los

Anxhelosit, ajo e Clippersit, mundi 117-97 Portlandin, ndeshje ku u dalluan Harrelli me 26 pikë e George me 25. Koha shtesë fatale për kampionët e Toronto, që u mundën 121-110 nga Miami. Butler realizoi një "triple double", me 22 pikë, 13 rebounde e 12 asistime, mbështetur nga Robinson me 22 pikë.

SHKURT

Shala në formacionin e vitit në Norvegji

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Herolind Shala, është përfshirë në formacionin më të mirë të vitit nga gazeta më e madhe në Norvegji, VG.no. Edhe pse Valerenga e tij nuk arriti të kapë një pozitë që e dërgon në Evropë, Shala ishte ndër lojtarët më të mirë në kampionatin norvegjez. 27-vjeçari zhvilloi 21 ndeshje këtë edicion duke munguar në nëntë prej tyre shkak i lëndimeve, por shënoi gjashtë gola dhe bëri pesë asistime si mesfushor defensiv.

Vetteli tallet me Hamiltonin

Pas garës së fundit në Abu Dhabi janë shtuar zërat se Lewis Hamiltoni mund të pilotojë një makinë Ferrari, duke nisur nga viti 2021. Çka do të thotë se një nga dy pilotët aktualë të "kokëkuqes" do të largohet. Në këtë rast, më i rrezikuari është Sebastian Vetteli, që i skadon kontrata pas një viti. Duke folur për këtë problem, Vetteli ka deklaruar: "Nuk e di se kush i ka përhapur këto fjalë por, me sa duket, di më shumë gjëra se unë". "Unë di që Hamiltoni është një pilot i Ferrarit... si një klient, pasi e ka blerë një makinë të tillë. Madje është një klient i mirë, pasi ka më shumë se një makinë Ferrari", ka thënë Vetteli.

Guardiola mund të rikthehet në Barcelonë

Pep Guardiola fitoi çmimin 'trajneri i vitit' nga Federata Katalanase të martën në mbrëmje. Babai i Pep Guardiolas, Valenti Guardiola, ishte i pranishëm për ta marrë trofeun, duke mos i iku pyetjes nëse djali i tij do të kthehej ndonjëherë te Barcelona. "Mund të jetë një po që ai të kthehet në Barcelona, por do të ishte si trajner. Që kur u largua nga shtëpia ai gjithmonë ka marrë vendimet e tij. Unë kurrë nuk e kam këshilluar atë", ka zbuluar Valenti Guardiola.

Ribery: Rikthehem shpejt, edhe më i fortë

Anësori Franck Ribery është larguar nga fusha për shkak të një lëndimi në ndeshjen mes Fiorentinës dhe Lecces. "Faleminderit për mesazhet tuaja! Tani duhet të mbetemi kompaktë me të gjithë tifozët e Fiores dhe të rikthehem sa më shpejt te fitoret. Po bëj gjithçka për t'u rikthyer sa më shpejt në fushë, këtë herë më i fortë se më përpara", ka thënë Ribery. Ylli francez është transferuar gjatë verës në skuadrën e Fiorentinës, pasi i kishte skaduar kontrata me skuadrën e Bayern Munchenit.

Reali dëshiron transferimin e Wernerit

Real Madridi është duke u interesuar për transferimin e një sulmuesi. Drejtuesit e klubit e kanë piketuar sulmuesin gjerman Timo Werner si përforcimin e radhës. 23-vjeçari edhe këtë sezon është duke treguar paraqitje të mira dhe ka arritur të shënojë 17 gola, ku vetëm sulmuesi polak Robert Lewandowski ka arritur të shënojë më shumë se ai. Ai ka një kontratë me klubin aktual, Leipzig, deri në vitin 2023, ndërsa drejtuesit madrilenë janë duke shqyrtuar mundësinë për ta futur në këtë operacion sulmuesin e blerë nga Frankfurti, Luka Joviq, i cili nuk ka pasur paraqitje të pritura në klubin mbretëror.

REZULTATET

Cleveland - Detroit	94-127
Washington - Orlando	120-127
New Orleans - Dallas	97-118
Toronto - Miami	110-121
San Antonio - Houston	135-133
Denver - Lakers	96-105
Clippers - Portland	117-97



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, General Hospital
"Dr. Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë/a

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës /Nr. 03/L-212/ si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ /MPMS/ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të MPMS, u.d. drejtori Ekzekutiv i Spitalit të Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" – Mitrovicë, mori vendim dhe shpallë:

KONKURS PUBLIK

Institucioni: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist – Reumatolog / një (1) pozitë/
Vendi i Punës: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Kategoria funksionale/Grada: koeficienti i pagës / 8.40 /
Kontrata e punës: Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/

Detyrat dhe përgjegjësitë: konform përshkrimit, detyrave dhe përgjegjësi të punës.

Institucioni: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist – Kirurg i Përgjithshëm /një (1) pozitë/
Vendi i Punës: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Kategoria funksionale/Grada: koeficienti i pagës / 8.40 /
Kontrata e punës: Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/

Detyrat dhe përgjegjësitë: konform përshkrimit, detyrave dhe përgjegjësi të punës.

Institucioni: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist – Gjinokologji me Obsterikë /një (1) pozitë/
Vendi i Punës: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Kategoria funksionale/Grada: koeficienti i pagës / 8.40 /
Kontrata e punës: Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/

Detyrat dhe përgjegjësitë: konform përshkrimit, detyrave dhe përgjegjësi të punës.

Institucioni: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist – Pulmolog /tri (3) pozita/
Vendi i Punës: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Kategoria funksionale/Grada: koeficienti i pagës / 8.40 /
Kontrata e punës: Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/

Detyrat dhe përgjegjësitë: konform përshkrimit, detyrave dhe përgjegjësi të punës.

Institucioni: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist – Mjekësi Emergjente /një (1) pozitë/
Vendi i Punës: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Kategoria funksionale/Grada: koeficienti i pagës / 8.40 /
Kontrata e punës: Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/

Detyrat dhe përgjegjësitë: konform përshkrimit, detyrave dhe përgjegjësi të punës.

- **Shkollimi i kërkuar për pozitën mjek specialist:** Të kenë arsimim universitar, specialist i lëmisë së kërkuar.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen për pozitën mjek specialist: Të kenë të mbaruar Fakultetin e Mjekësisë dhe specializimin adekuat të lëmisë përkatëse. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë notën mesatare më të lartë gjatë studimeve themelore, njohuri të gjuhës angleze dhe që kanë trajnime të veçanta në fusha profesionale, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës; Të kenë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të kenë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim, njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

Dokumentet e kërkuara për pozitën mjek specialist: Diploma e Fakultetit, Certifikata e specializimit, Licenca e Punës valide e Mjekut Specialist nga Institucioni kompetent i Republikës së Kosovës, kopje të letërnjoftimit, si dhe çdo dokument apo certifikatë trajnimi që kandidati e vlerëson si përparësi në përgatitje të tij. Dokumentet e kërkuara të dorëzohen në kopje, origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vertetuara në noteri do të kërkohe vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

Institucioni: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Titulli i vendit të punës: Mr.ph. Farmacist /një (1) pozitë/
Vendi i Punës: Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Kategoria funksionale/Grada: koeficienti i pagës /7.20 /
Kontrata e punës: Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/

Detyrat dhe përgjegjësitë: vërtetohet kërkesën e sasisë së barërave dhe në bazë të saj bënë furnizimin e barërave dhe medikamenteve tjera mjekësore., kontrollon dhënien, përdorimin dhe ruajtjen e barërave., mbanë evidencë të rregullt të dokumentacionit për dorëzimin e barërave në repart., kryen punë tjera specifike të farmacistit si dhe kryen punë tjera konform përshkrimit të vendit të punës.

Shkollimi i kërkuar: të kenë arsimim universitar, Mr.ph. Farmacist.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen: të kenë arsimim universitar, Mr.ph. Farmacist. Të tregoj shkathësi organizimi, kordinimi, dhe planifikimi, të kenë trajnime të veçanta në fusha profesionale, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës; Të kenë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të kenë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim, njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

Dokumentet e kërkuara: Diploma Universitare Mr.ph. Farmacist., Licenca e Punës valide nga Institucioni kompetent i Republikës së Kosovës, kopje të letërnjoftimit, si dhe çdo dokument apo certifikatë trajnimi që kandidati e vlerëson si përparësi në përgatitje të tij. Dokumentet e kërkuara të dorëzohen në kopje, origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vertetuara në noteri do të kërkohe vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë veprimi, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësitë e kërkuara profesionale për kryerjen e detyrave.

"Spitali i Përgjithshëm – Mitrovicë ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komunitetet jo shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional".

Procedurat e konkurimit: Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin: Procedurat e rekrutimit rregullohen sipas Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës / Nr. 03/L-212/ si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ /MPMS/ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të MPMS.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen dhe kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Arkivës në Spitalin e Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" – Mitrovicë, Lagja Bair - 40.000, Mitrovicë. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës.

Kontaktet me telefon mund të bëni në 028-530-811.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-
Ministry of Health



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University
Clinical Service of Kosovo

Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, General Hospital "Dr. Sami
Haxhibeqiri" Mitrovicë

Na osnovu clana 8. Zakona o radu Republike Kosova/br. 03/L-212/, Administrativnog Uputstvo /MRSZ/ br. 07/2017 za regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, izvršni direktor Opšte Bolnice "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica, doneo je odluku o raspisivanju:

JAVNOG KONKURSA

Institucija: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Naziv radnog mesta: Lekar specijalista-Reumatologija /jedna (1) pozicije/
Radno mesto: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Funksionalna kategorija/stepen: Koeficient LD /8.40/
Ugovor o radu: Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/.

Institucija: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Naziv radnog mesta: Lekar specijalista-Opsti Hirurg /jedna (1) pozicije/
Radno mesto: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Funksionalna kategorija/stepen: Koeficient LD /8.40/
Ugovor o radu: Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/.

Institucija: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Naziv radnog mesta: Lekar specijalista-Akusersko i Ginekologija /jedna (1) pozicije/
Radno mesto: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Funksionalna kategorija/stepen: Koeficient LD /8.40/
Ugovor o radu: Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/.

Institucija: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Naziv radnog mesta: Lekar specijalista-Pulmologije /tri (3) pozicija/
Radno mesto: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Funksionalna kategorija/stepen: Koeficient LD /8.40/
Ugovor o radu: Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/.

Institucija: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Naziv radnog mesta: Lekar specijalista-Urgentnu Medicinu /jedna (1) pozicije/
Radno mesto: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Funksionalna kategorija/stepen: Koeficient LD /8.40/
Ugovor o radu: Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/.

Zadaci i odgovornosti: u skladu sa opisom poslova i radnih zadataka lekara specijalistu

Potrebno školovanje za lekara specijalista: Univerzitetska stručna sprema, specijalista odgovarajuće oblasti.

Sposobnosti/iskustvo i ostali atributi za lekare specijalista: Kandidati treba da imaju završen medicinski fakultet, specijalizaciju odgovarajuće oblasti. Prednost će imati kandidati koji u toku studija imaju veću prosečnu ocenu, poznavanje engleskog jezika, koji imaju posebne stručne obuke, dobro poznavanje funkcionisanja Zdravstvenog Sistema Kosova. Da imaju dokazane sposobnosti za efektivnu komunikaciju na pismenom i govornom aspektu, da imaju znanja službenih jezika na upotrebi, znanje za upotrebu kompjutera je obavezna.

Potrebna dokumentacija za radno mesto lekara specijalista: Diploma fakulteta, Uverenje o specijalizaciji, licenca rada lekara specijalista od odgovorna institucija Republike Kosova, fotokopije lične karte kao i druga dokumentacija ili uverenja o stručnom usavršavanju koji kandidat smatra za prednost svoje stručne spreme. Tražena dokumentacija dostavlja se kopirana, originalna i overena dokumentacija kod notera tražice se samo kada se vrši prijem kandidata u radni odnos.

Institucija: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Naziv radnog mesta: Mr.ph. Farmacista /jedna (1) pozicije/
Radno mesto: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Funksionalna kategorija/stepen: Koeficient LD /7.20/
Ugovor o radu: Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/.

Zadaci i odgovornosti: u skladu sa opisom poslova i radnih zadataka lekara specijalistu

Potrebno školovanje: Univerzitetska stručna sprema, Mr.ph. Farmacista.

Sposobnosti/iskustvo i ostali atributi: Kandidati treba da imaju završen Mr.ph. Farmacista. Koji imaju posebne stručne obuke, dobro poznavanje funkcionisanja Zdravstvenog Sistema Kosova. Da imaju dokazane sposobnosti za efektivnu komunikaciju na pismenom i govornom aspektu, da imaju znanja službenih jezika na upotrebi, znanje za upotrebu kompjutera je obavezna.

Potrebna dokumentacija za radno mesto: Diploma fakulteta, Mr.ph. Farmacista, licenca rada od odgovorna institucija Republike Kosova, fotokopije lične karte kao i druga dokumentacija ili uverenja o stručnom usavršavanju koji kandidat smatra za prednost svoje stručne spreme. Tražena dokumentacija dostavlja se kopirana, originalna i overena dokumentacija kod notera tražice se samo kada se vrši prijem kandidata u radni odnos.

Uslovi za učestovanje na konkurs: Pravo za aplikaciju imaju svi odrasli državljani Republike Kosova, koji imaju punu radnu sposobnost, koji su završili adekvatno obrazovanje i koji imaju traženu stručnu sposobnost za obavljanje poslova i radnih zadataka.

"Opšta Bolnica – Mitrovica pruža jednake mogućnosti zaposljavanja svim državljanima Kosova i rado prima prijave za zaposljavanje od svi lica muskog i zenskog pola iz svih zajednica na Kosovu".

"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prava da budu proporcionalno predstavljani na sektoru zaposljavanja"

Postupak konkurisanja: Konkurisanje je javno za sve zainteresovane kandidate.

Zakonski i podzakonski propisi koji uređuju konkurisanje: Postupak rekrutacije propisano je Zakonom o Radu Republike Kosova, /br. 03/L-212./, Administrativnog Uputstvo /MRSZ/ br. 07/2017 za regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru.

Datum zatvaranja konkursa: 15 dana od dana oglašavanja. Zahtevi dostavljeni nakon isteka roka neće se primiti kao i nekompletna dokumentacija neće se razmatrati. Zbog velikog broja dostavljenih zahteva, samo kandidati izabrani na listu užeg izbora će se kontaktirati.

Dostavljanje zahteva: Aplikacije uzimaju se i dostavljaju se u Kancelariji Pisarnice Opšte Bolnice "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica, Naselje "Bair" 40.000 Mitrovica.

Na aplikaciji treba jasno da se naznači naziv radnog mesta. Kandidati mogu da kontaktiraju na tel: 028/530-811.



AGJENCIA
PËR INVESTIME
DHE PËRKRAHJEN
E NDMARRJEVE
NË KOSOVË **KIESA**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)


NJOFTIM PËR VAZHDIM AFATI

Njoftohen të gjithë kompanit prodhuese të interesuar për pjesëmarrje në panairin "Green Week 2020" se zgjatet afati për aplikim deri me 12.12.2019 për Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin "Green Week 2020" në Berlin të Gjermanisë më 17-26 janar 2020, të shpallura me datë 15.11.2019 në gazeta ditore dhe web.

Aplikimi mund të bëhet deri me datë 12.12.2019 në adresën e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë Rruga Muharrem Fejza, Lagjja e Spitalit, p.n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Afati i fundit për aplikim është data 12.12.2019 ora 16:00.

Contract Title: Increases of competitiveness in the market specifically export markets by producing added value products.



Publication reference: 01/2019

ZINKUNIE-KS SH.P.K. intends to award a supply contract for "Automatic and manual coating technology and auxiliary tools", in Prizren, with financial assistance from the European Union Office in Kosovo (DELEG XK). The tender dossier is available from www.zinkunie-ks.com

The deadline for submission of tenders is 20 December 2019, 15:00 hrs.



AGJENCIA
PËR INVESTIME
DHE PËRKRAHJEN
E NDMARRJEVE
NË KOSOVË **KIESA**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

SAOPŠTENJE ZA PRODUŽENJE ROKA

Saopštavaju se svi proizvodne kompanie zainteresovani za učesće na sajmu "Green Week 2020" da se rok za apliciranje produžava do 12.12.2019 na Javni Poziv za apliciranje za učesće na državnom štandu Kosova na sajmu "Green Week 2020" u Berlinu, Nemačka, 17-26 januara 2020, objavljen 15.11.2019 u dnevničkim novinama i web.

Apliciranje se može podneti do 12.12.2019 na adresu Ministarstva Trgovine i Industrije Ulica Muharrem Fejza, b.b. Priština, 10000, Republika Kosovo.

Zadnji rok za apliciranje je do: 12.12.2019, u 16:00 časova.



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

**NJOFTIM PËR VAZHDIMIN
E AFATIT TË KONKURISIT**

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti"Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Dy (2)-Pozita Punëtor Fizik -Njësia në Mitrovicë - K.R.M.'Uniteti"Sh.A - Konkursit të shpallur me datë 14.11.2019

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej datës 04.12.2019. gjerë me datë.11.12.2019.

Vërejtje:Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës,nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri.Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:674/1
Dt: 03.12.2019

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Administrativ Nr. 10/2018 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira në Sh. M. M “Shtjefën Gjeçovi” Prishtinë, Sh. M. L. P në “11 Marsi” në Prizren, Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2019/2020

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh.M.L.P	“Shtjefën Gjeçovi”	Prishtinë	Një (1) mësimdhënës për lëndët profesionale të tekstit 20 orë mësimore	Deri me 31.08.2020 me mundësi vazhdimi
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndët zgjedhore 10 orë në Qendrën e Karrierës;	Vend i lirë
			Dy(2) instruktor/e nga 20 orë të	Vend i lirë
			praktikes profesionale për lëmin e metalpunues, saldator, Dirigjimi Kompjuterik i Makinave dhe Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit;	
Sh. M. L. T	“11 Marsi”	Prizren	Një (1) mësimdhënës/e të Gjuhës Angleze (20 orë)	Deri me 31.08.2020
			Një (1) mësimdhënës/e të Gjuhës Angleze (10 orë)	Deri me 31.08.2020
Sh.M.L.P	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një(1)mësimdhënës/e të Instalimeve elektrike me normë të plot	Deri në kthimin e mësimdhënës nga pushimi i lehonisë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë plan programin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e plan programit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.

- Diagnostikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor;

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Të ketë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Sh. M. M “Shtjefën Gjeçovin” në Prishtinë, Qendrën e Kompetencës në Skenderaj dhe Sh. M. L. T “11 Marsi” në Prizren.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA
 ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:675 /1
 Dt: 03.12.2019

Në bazë të nenit 23 i Ligjit nr. 06/L-113, Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, si dhe Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur*

Departamenti: **Administratë Financa**
 Paga bruto: **423.85 €**

Titulli i vendit të punës: **Zyrtar për financa/Zyrtar i shpenzimeve (1 vend pune)**

Kohëzgjatja e kontratës: **gjatë (6) mujore**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron që shpenzimet e buxhetit të bëhen në pajtim me rregullat dhe procedurat financiare si dhe në pajtim me politikat e ministrisë;
- Kontrollon karakterin ekonomik të shpenzimeve në bazë të dokumentacionit përcjellës dhe kryen pagesat nëpërmes sistemit SIMFK;
- Përgatit dhe kompletion dokumentacionin e nevojshëm për certifikimin e shpenzimeve buxhetore për të gjitha njësit organizative;
- Sistemon dhe regjistron të gjitha shpenzimet buxhetore në sistem, analizon ccurinë e tyre dhe mban evidencën e tyre sipas strukturës së shpenzimeve;
- Përgatit raporte tremujore, gjashtëmujore mbi shpenzimet buxhetore në bazë të LMFP-së;
